



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 59 regjistër (JR)
Datë 16.12.2020

Nr. 12 i vendimit
Datë 30.03.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Rezarta Schuetz	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 30.03.2023, ditën e enjte, në orën 11:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 284, datë 03.08.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Hysen Saliko.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni F i Aneksit të Kushtetutës, neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet 63 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet e depozituara para seancës gjyqësore, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 284, datë 03.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko, (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), prej të cilëve rezultoi si më poshtë.
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, (në vijim “Komisioni”), një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me nr. {***} prot., datë 24.05.2018, nga i cili ka rezultuar se:
 1. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
 2. *Nuk ka paraqitur dokumentacion për të justifikuar pasuritë;*
 3. *Ka mosdeklarime në interesat private ndër vite;*
 4. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parashikimeve në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, raportin e Grupit të Punës, nr. {***}, datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin

nr. {***}, datë 08.01.2019, ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Hysen Saliko, për vazhdimin e detyrës së gjyqtarit.

5. KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport¹ të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.
6. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në tria kriteret e vlerësimit, atë të pasurisë, të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit, si dhe pasi shqyrtoi të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin që subjektit të rivlerësimit Hysen Saliko, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 284, datë 03.08.2020, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit nga detyra është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej kriterëve të vlerësuar.

7.1 Për vlerësimin e kriterit të pasurisë: *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë e tij, sipas pikave 1 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim, referuar paragrafit 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, gerrat “a”, “b”, “ç” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive, në kuptim të gërmës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesit duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 3, pika 4, shkronja “b” e ligjit “Mbi parandalimin e Konfliktit të Interesit” dhe sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016.*

7.2 Për kriterin e kontrollit të figurës: *Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe të integritetit të subjektit të rivlerësimit Hysen Saliko, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.*

¹ Raporti i KLGj-së nr. {***} prot., datë 11.09.2019.

7.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Komisioni vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.*

III. Mbi ankimin dhe shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit

8. Më datë 01.12.2020 është depozituar nga subjekti i rivlerësimit ankimi i protokolluar në Komision me nr. {***} prot., kundër vendimit nr. 284, datë 03.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63², pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në konkluzion, subjekti i rivlerësimit kërkoi që shkaqet e ankimit t'i marrë në shqyrtim Kolegji, duke kërkuar:

8.1 Prishjen e vendimit nr. 284, datë 03.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

8.2 Konstatimin e pavlefshmërisë së procedurës së hetimit administrativ, seancës gjyqësore, vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare të trupit gjykues.

8.3 Kryerjen e hetimit gjyqësor nga fillimi. Marrjen e provave të kërkuara prej subjektit në Komision, si dhe ato të reja.

8.4 Korrigjimin e gabimeve procedurale të vendimit, duke e gjykuar çështjen në seancë gjyqësore publike.

8.5 Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Hysen Saliko, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

8.6 Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

8.6.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni gjatë procesit administrativ ka vendosur ndaj subjektit të rivlerësimit një barrë prove të paarsyeshme, jo proporcionale, jo objektive dhe në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 52 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kundërshtim me nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti parashtron se kur Komisioni krijon bindjen se subjekti nuk ka përmbushur një detyrim ligjor të përcaktuar duhet t'ia bëjë me dije këtë mangësi.

8.6.2 Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi objekt ankimi është i paarsyetuar, tërësisht alogjik dhe i paracaktuar. Referuar praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e drejta për t'u dëgjuar nuk përfshin vetëm të drejtën për të paraqitur pretendime para gjykatës, por edhe detyrimin korrespondues të gjykatës për t'i dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura. Subjekti i rivlerësimit pretendon se mungojnë si provë aktet e Njësisë së Shërbimit Ligjor të Komisionit, të cilat marrin vlerën e aktit të ekspertimit në mungesë të kryerjes së një ekspertimi nga ekspertë të pavarur, si dhe vendimi për marrjen si provë të tyre.

8.6.3 Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se shkeljet flagrante të kryera nga Komisioni dhe mosrespektimi i hapur i parimeve të procesit të rregullt ligjor, duket se kanë burimin te

² "Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit".

fakti i mosformimit të trupit gjykues sipas ligjit, ndaj çdo akt i krijuar nga trupi gjykues i kësaj çështjeje është i pavlefshëm, pasi është marrë nga një gjykatë e formuar jo sipas ligjit.

8.6.4 Subjekti i rivlerësimit pretendon se trupi gjykues i Komisionit nuk ka qenë i pavarur dhe i paanshëm. Sipas subjektit të rivlerësimit njëanshmëria është vënë re kur është pyetur në seancën dëgjimore në Komision nga kryesuesja e trupit gjykues *“si ka mundësi që kryen katër punë njëherësh”*.

8.6.5 Subjekti i rivlerësimit pretendon se nga Komisioni nuk është respektuar parimi i sigurisë juridike, parimi i diskrecionit, proporcionalitetit dhe objektivitetit në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës. Në Komision shpenzimet për udhëtimet janë llogaritur nga një metodologji e përcaktuar nga ILDKPKI-ja. Subjekti pretendon se Komisioni ka krijuar ligj, kompetencë të cilën Kushtetuta ia njeh Kuvendit të Shqipërisë, duke shkelur kështu parimin e sigurisë juridike, pasi mungon ligji ku duhet të referohej.

8.6.6 Subjekti i rivlerësimit pretendon se në Komision nuk është kryer një proces i rregullt ligjor nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm në zbatim të parimit të kontradiktoritetit. Ai pretendon se në seancë dëgjimore ka kërkuar të administrohet një provë, të cilën nuk ka pasur mundësi ta merrte, (raport kontrolli i shoqëruar me shkresën nr. {***} prot., datë 26.03.2013, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, i mbajtur për shoqërinë *“{***}”* ShPK) dhe kërkon që këtë provë ta marrë Kolegji. Subjekti i rivlerësimit këtë dokument e ka dorëzuar në seancën e shpalljes së vendimit të Komisionit, më 03.08.2020.

Shkaqe ankimi lidhur me kriterin e pasurisë

8.6.7 Lidhur me pasurinë shtëpi banimi në fshatin {***}, Njësia Administrative Mollas, Bashkia Kolonjë, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk i ka kaluar asnjë barrë prove lidhur me saktësinë e deklaramit, pasi ka konkluduar në rezultatet e hetimit se kjo pasuri është deklaruar saktë. Subjekti pretendon se pavarësisht mungesës së dokumentacionit të plotë, e cila ka ndodhur për shkaqe të pavarura nga ai, Komisioni e ka konsideruar të saktë deklaramin e subjektit të rivlerësimit.

8.6.8 Lidhur me pasurinë tokë bujqësore me sip. 34.150 m², ndodhur në fshatin {***}, Njësia Administrative Mollas, Bashkia Kolonjë, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e arritura nga shumica e trupit gjykues, bazohen në akte të pavërteta dhe nuk i përgjigjen realitetit të ndodhur, si dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ. Subjekti pretendon se me deklaratat noteriale lëshuar nga motrat e tij ka provuar se ato kanë hequr dorë nga pasuria e përfituar sipas AMTP-së.

8.6.9 Lidhur me të ardhurat e realizuara nga bujqësia, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim, se ka provuar që këto të ardhura të realizuara nga ferma bujqësore, jo vetëm që janë të ligjshme, por edhe në masën e atyre vlerave të deklaruara ndër vite në DIPP-të përkatëse. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në asnjë prej dispozitave ligjore nuk përmendet detyrimi i bujkut privat për të deklaruar të ardhurat nga bujqësia në organet tatimore dhe për më tepër detyrimi për të paguar tatim për këto të ardhura.

8.6.10 *Lidhur me apartamentin e banimit me sip. 106,44 m², i ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se sa i përket ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga bujqësia si burim i krijimit të pasurisë apartament banimi ka provuar dhe shpjeguar tej çdo dyshimi të arsyeshëm ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Subjekti pretendon se i është përfshirë gabimisht në analizën financiare një transaksion prej 30.000 eurosh në Bankën Kombëtare Tregtare, për të cilin pretendon se nuk është ai personi që ka depozituar këtë shumë për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK.*

8.6.11 *Lidhur me dy garazhet e ndodhur në katin e dytë nëntokë të godinës 9-katëshe, me sipërfaqe 15,8 m² secili, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive në vitin 2015, në shumën 872.420 lekë është i gabuar. Sipas subjektit, Komisioni edhe për këtë vit në mënyrë të padrejtë nuk i ka konsideruar të ardhurat nga bletaria dhe pemëtaria.*

8.6.12 *Lidhur me automjetin tip “Volkswagen Bora”, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2008, në shumën 628.850 lekë është i gabuar. Sipas subjektit, Komisioni edhe për këtë vit në mënyrë të padrejtë nuk i ka konsideruar të ardhurat nga bujqësia dhe bletaria.*

8.6.13 *Në lidhje me llogarinë rrjedhëse të krijuar në “Credins Bank” në vitin 2016, në emër të shtetasve L. dhe M. S. (bashkëshortja dhe nëna e subjektit të rivlerësimit), subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit në lidhje me këtë çështje është në shkelje të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, të nenit 87 të Kodit të Procedurës Administrative, si dhe të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit pretendon se faturat tatimore janë akte me fuqi të plotë provuese dhe janë tituj ekzekutivë për sa i përket rimbursimit të TVSh-së, ndaj vlefshmëria e tyre nuk vihet në dyshim dhe se motrat e tij nuk janë bashkëpërfituese të këtyre të ardhurave.*

8.6.14 *Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 86,89 m², ndodhur në blv. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit se subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 3.754.249 lekë, për krijimin dhe mobilimin e kësaj pasurie, është i gabuar dhe jo logjik. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo balancë negative është shumatore e balancave negative të përlllogaritura nga Komisioni në vitet 2011-2014, pasi nuk janë përfshirë të ardhurat nga pemëtaria dhe bletaria, si dhe shuma prej 1.600.000 lekësh, e cila iu dhurua nuses së djalit nga prindërit e saj me rastin e martesës.*

8.6.15 *Lidhur me banesën në përdorim në rr. “{***}”, Vlorë, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është jo logjik dhe tërësisht i pabazuar në ligjin mbi konfliktin e interesit dhe në kundërshtim me praktikën e Komisionit.*

8.6.16 *Lidhur me gjetjen e Komisionit për punësimin e subjektit të rivlerësimit pranë Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë (në vijim “UISH”), subjekti i rivlerësimit pretendon se pasqyrimi në kontratën e punësimit ka qenë jo i saktë, pasi pranë UISH-së ka kryer vetëm aktivitet mësimdhënës. Kontrata e lidhur me këtë institucion është një kontratë tip dhe vetëm shënimi në këtë kontratë i fjalës “konsulencë” nuk provon faktin që nga ankuesi është dhënë konsulencë për UISH-në.*

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin kalimtar të subjektit Hysen Saliko, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65³, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 284, datë 03.08.2020, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Hysen Saliko, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

11.1 Trupi gjykues shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur në ankim, ku kërkoi nga Kolegji që gjykimi i çështjes së tij të zhvillohet në seancë gjyqësore publike, çeljen e hetimit gjyqësor, të administrohen si prova të reja aktet që i ka bashkëngjitur ankimit dhe parashkrimeve, si dhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen si provë të një akt ekspertimi financiar nga ekspertë të pavarur dhe të paanshëm.

11.2 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur ankimit disa akte, pjesa më e madhe e të cilave janë të administruara në dosjen e Komisionit, ndërsa pjesa tjetër janë paraqitur⁴ për herë të parë

³ "Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

⁴ - Vërtetim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Korçë, pa nr. protokollit, datë 16.11.2020., për vjetërsinë në punë të subjektit të rivlerësimit si punëtor i kooperativës bujqësore Selenicë, nga viti 1979 – 1991, sipas të cilit paraqiten ditët e punës të kryera gjatë këtyre viteve.

- Vërtetim i Bashkisë Kolonjë, me nr. {***} prot., datë 19.11.2020, nëpërmjet të cilit sqarohet se regjistrimi i pasurive të paluajtshme të fshatit {***}, Bashkia Kolonjë, ka filluar dhe është në fazën e afishimit të pronave dhe nuk mund të bëhen regjistrime për subjekte dhe prona të veçanta.

bashkë me ankimin. Subjekti i rivlerësimit, më datë 27.12.2022, paraqiti në Kolegj parashtrimet për çështjen e tij, të protokolluara në Kolegj me nr. {***} prot., të cilave i ka bashkëngjitur edhe disa akte⁵, për të cilat kërkoi të merren si prova të reja nga Kolegji. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe parashtrimet “shtesë ankimi”, datë 21.02.2023, të cilat janë protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., së bashku me disa akte⁶. Më datë 24.03.2023, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur sërish parashtrime, të cilat janë protokolluar me nr. {***} prot., në Kolegj.

11.3 Bazuar në parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”), i ndryshuar, parashikohet se: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërktojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”, si edhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: “Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimin; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit”. Bazuar në parashikimet ligjore cituar më sipër, Kolegji vendosi refuzimin e marrjes në cilësinë

- Vërtetim i Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, me nr. {***} prot., datë 26.11.2020, sipas të cilit sqarohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë konsulencë për UISh-në për çështjet civile apo administrative të ngritura nga UISh apo kundër UISh-së.

- Raport kontrolli i shoqëruar me shkresën nr. {***} prot., datë 26.03.2013, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, i mbajtur për shoqërinë “{***}” ShPK.

⁵ - Vendim nr. {***} regj. them., datë 01.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Urdhër i datës 05.11.2021, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për ekzekutimin e vendimit penal nr. {***} regj. them., datë 01.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Kërkesë drejtuar Zyrës Vendore të ASHK-së Kolonjë, datë 12.09.2022.

- Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 13.09.2022, e Zyrës Vendore të ASHK-së Kolonjë.

- Raportim informues i subjektit të rivlerësimit, datë 05.05.2021, drejtuar ONM-së.

- Vendimi nr. {***} prot., datë 30.07.2021, i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me ankesën e subjektit Ll. Xh..

⁶ - Transkripti i audios së seancës dëgjimore në Komision, e zbardhur nga vetë subjekti i rivlerësimit.

- Foto të fshatit {***} dhe të parcelës së mollëve, të nxjerra nga programi google earth, të cilat gjenden të administruara në dosjen e Komisionit.

- Kërkesë për marrje provash shkresore drejtuar Komisionit, datë 29.07.2020.

- Kërkesë për riçelje hetimi administrativ dhe marrje provash drejtuar Komisionit.

- Kthim përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë me nr. {***} prot., datë 15.02.2023.

- Kthim përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë me nr. {***} prot., datë 14.07.2020.

- Shkresë e Ministrisë së Drejtësisë me nr. {***} prot., datë 10.05.2006, e cila gjendet e administruar në dosje.

- E-mail nga B. V., datë 04.05.2006, si dhe dokumentacion bashkëlidhur, për një udhëtim në Kroaci, nga data 30.05.2006 - 01.06.2006.

- Urdhër i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nr. {***}, datë 22.05.2015.

- Urdhër i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nr. {***}, datë 12.06.2015.

- Dokumentacion për apartamentin me sip. 106,44 m² (kontratë sipërmarrje, mandatarkëtim, certifikatë pronësie), i cili gjendet i administruar në dosje.

- Dokumentacion nga kunati në Greqi, të cilin e ka paraqitur në gjuhën greke dhe të papërkthyer e noterizuar, si dhe pa vulë apostile.

e provave të reja të akteve të paraqitura me ankimin dhe parashtrimet nga subjekti i rivlerësimit, duke arsyetuar si vijon:

11.4 Në zbatim të parashikimeve ligjore, lidhur me këtë çështje, Kolegji vlerësoi se për aktet e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve, nuk provohet pamundësia e paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ në Komision nuk ka qenë pa fajin e tij, siç kërkon neni 47 i ligjit nr. 49/2012, por edhe sikur të ishin në plotësim të këtyre kriterëve, nuk konsiderohen të nevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si të tilla që, edhe sikur të konsideroheshin me vlerë provuese për fakte që edhe po të konsiderohen të vërtetë, ato nuk ndikojnë në marrjen e vendimit, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016. Për aktet që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur lidhur me çështjen e pagimit të shumë 30.000 euro në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, nëpërmjet BKT-së, turpi gjykues vlerësoi se analizimi i situatës faktike mund të bëhej mbi bazën e akteve të administruara në fashikullin e Komisionit dhe nuk ishte e nevojshme marrja e provave të tjera.

11.5 Në vlerësim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për gjykimin e çështjes nga Kolegji në seancë gjyqësore publike, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegji, me praninë e subjektit të rivlerësimit. Në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, gjykimi në Kolegji, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Trupi gjykues vlerësoi se: (a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; (b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; si dhe (c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e një ekspertimi financiar nga ekspertë të pavarur, trupi gjykues vlerësoi se si Komisioni, ashtu dhe Kolegji, bazuar në parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016, në strukturën e tyre organizative si pjesë të Njësisë së Shërbimit Ligjor kanë edhe këshilltarë ekonomikë, të cilët këshillojnë dhe ndihmojnë trupin gjykues për çështjet financiare dhe ekonomike dhe, si rrjedhojë, nuk është e nevojshme kryerja e një ekspertimi nga ekspertë të pavarur. Për sa më sipër, trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezultoi i nevojshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit dhe vendosi të vijojë ta shqyrtojë çështjen në formën e gjykimit të zhvilluar në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit

Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni gjatë procesit administrativ ka vendosur ndaj tij një barrë prove të paarsyeshme, jo proporcionale, jo objektive dhe në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 52 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kundërshtim me nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative. Gjithashtu, në themel të vendimit janë vendosur fakte dhe shkaqe, për të cilat subjektit nuk i ka kaluar barra

e provës. Ai parashtron se kur Komisioni krijon bindjen se subjekti nuk ka përmbushur një detyrim ligjor të përcaktuar, duhet t'ia bëjë me dije këtë mangësi, nëse ky element konsiderohet se mund ta çojë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, me qëllim që t'i garantohet e drejta për të paraqitur prova dhe argumente për t'u dëgjuar e mbrojtur në mënyrë efektive ndaj gjetjeve që prezumojnë shkarkimin nga detyra. Këto pretendime të subjektit të rivlerësimit do të analizohen më poshtë në këtë vendim, së bashku me shkaqet e ankimit me natyrë materiale që lidhen me analizimin e problematikave të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

13. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi objekt ankimi është i paarsyetuar, tërësisht alogjik dhe i paracaktuar. Referuar praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e drejta për t'u dëgjuar nuk përfshin vetëm të drejtën për të paraqitur pretendime para gjykatës, por edhe detyrimin korrespondues të gjykatës për t'i dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura. Subjekti argumenton se për të vlerësuar që palët në proces janë dëgjuar, duhet që në vendimin gjyqësor të jepen argumentet e mjaftueshme nëse gjykata ka pranuar apo rrëzuar argumentet e paraqitura. Subjekti i rivlerësimit pretendon se mungojnë si provë aktet e Njesisë së Shërimit Ligjor të Komisionit, të cilat marrin vlerën e aktit të ekspertimit në mungesë të kryerjes të një ekspertimi nga ekspertë të pavarur, si dhe vendimi për marrjen si provë të tyre. Sipas subjektit, vendimi i Komisionit ishte i paracaktuar dhe se gjuha e përdorur në vendim është denigruese, pasi hidhen dyshime mbi të ardhurat e siguruara nga familja e tij ndër vite.

13.1 Kolegji vëren se në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, mbajmë në konsideratë jurisprudencën⁷ e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e cila thekson domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Kjo gjykatë ka vlerësuar se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Ajo arsyeton se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimet përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Gjykata verifikon nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërcituara. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi është arsyetuar në përputhje me standardet e kërkuara nga Gjykata Kushtetuese dhe, si rrjedhojë, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi është i paarsyetuar dhe tërësisht alogjik.

13.2 Në vlerësim të shkakut të mësipërm të ankimit, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për vendim paragjykes dhe të paracaktuar, nga verifikimi i procedurave të ndjekura nga Komisioni, konstatohet se me vendimin e tij nr. {***}, datë 19.09.2018, ka nisur

⁷ Shih vendimet nr. 3, datë 26.01.2015, nr. 63, datë 23.09.2015, nr. 24, datë 25.04.2016 dhe nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese.

hetimi administrativ i thellë dhe i gjithanshëm për rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi analizoi raportet e dërguara nga institucionet ndihmëse, si: ILDKPKI, DSIK dhe KLGj, filloi hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësisë profesionale, duke kërkuar informacion nga subjekte të së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, dhe se me vendimin nr. {***}, datë 18.06.2020, “Për mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Hysen Saliko”, është vendosur të *përfundojë hetimi kryesisht për subjektin e rivlerësimit, për tri kriteret e vlerësimit dhe i ka komunikuar subjektit të rivlerësimit “rezultatet e hetimit administrativ”*, duke i kaluar barrën e provës për një sërë gjetjesh dhe e ka ftuar të japë shpjegime dhe të mbrohet lidhur me to. Rezulton se hetimi administrativ është shtrirë në një afat të konsiderueshëm kohor dhe ky fakt tregon se është i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se procesi i rivlerësimit kalimtar të tij ka qenë i paracaktuar dhe paragjykes. Në vendim nuk konstatohet gjuhë denigruese, siç pretendon subjekti i rivlerësimit.

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se shkeljet flagrante të kryera nga Komisioni dhe mosrespektimi i hapur i parimeve të procesit të rregullt ligjor, duket se kanë burimin te fakti i mosformimit të trupit gjykues sipas ligjit, ndaj çdo akt i krijuar nga trupi gjykues i kësaj çështjeje është i pavlefshëm, pasi është marrë nga një gjykatë e formuar jo sipas ligjit. Subjekti i rivlerësimit parashtron se anëtarët e Komisionit gëzojnë statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, sipas pikës 3 të nenit C të Aneksit të Kushtetutës, duke analizuar kushtet e zgjedhshmërisë së anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe bën krahasimin me kushtet e zgjedhshmërisë së anëtarëve të Komisionit me pretendimin se këto kushte nuk i përmbushin dy nga anëtarët e trupit gjykues, znj. S. Zh. dhe znj. E. Ç.. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se anëtarët e trupit gjykues të Komisionit nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 6 i ligjit nr. 84/2016 dhe neni C, pika 5 të Aneksit të Kushtetutës, duke kontestuar procesin e zgjedhjes së tyre nga Kuvendi i Shqipërisë. Subjekti pretendon se për shkak të mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit, trupi gjykues nuk ka qenë i pavarur dhe i paanshëm.

14.1 Lidhur me këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit çmon se parashikimet e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016 kanë vendosur kriteret specifike për zgjedhjen e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, të cilat janë të ndryshme me kriteret e vendosura për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe, si rrjedhojë, fakti që anëtarët e Komisionit nuk plotësojnë kushtet e zgjedhshmërisë së anëtarëve të Gjykatës së Lartë, nuk vlerësohet se përbën cenim të parimit të gjykatës së krijuar me ligj. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit, që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t’i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t’i paraprinte emërimit fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t’i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të

përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, trupi gjykues i Kolegjit referuar dhe jurisprudencës⁸ së tij çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Si rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për mospërmbushje të kushteve të zgjedhshmërisë për dy anëtarët që kanë gjykuar çështjen e tij në Komision, nuk gjendet i bazuar.

14.2 Në vazhdim të analizës së këtij shkakut ankimi, konstatohet se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit, si pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin e saj, lidhur me çështjen gjyqësore *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, ka arsyetuar: “[...] Për sa i përket mos përfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, Gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih *Oleksandr Volkov*). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kish pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tre kritereve dhe ka për qëllim rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është “sui generis” dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin. Ajo vëren se këto anëtarë u përzgjodhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj. Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë [...]”. GjEDNj-ja në vijim ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mospasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar, për rrjedhojë, shkelje të nenit 6 të KEDNj-së lidhur me sa më sipër.

14.3 Nga aktet e fashikullit të Komisionit rezulton se subjektit i janë dhënë të gjitha mundësitë dhe garancitë për t’u mbrojtur, duke i dhënë të drejtën të paraqesë shpjegime në lidhje me: (i) rezultatet e hetimit; (ii) kalimin e barrës për të provuar të kundërtën e asaj çka ka rezultuar nga hetimi; dhe (iii) vlerësimin e provave. Po ashtu, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur kërkesa apo pretendime për konflikt të mundshëm interesi me anëtarët e trupit gjykues, të ketë kërkuar përjashtimin e ndonjë anëtari apo që ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues të ketë kërkuar heqje dorë, gjë që mund të vinte në dyshim paanësinë e gjykimit dhe cenimin e procesit të rregullt ligjor. Gjithashtu, anëtarët e trupit

⁸ *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 43/2022 (JR), datë 15.11.2022; nr. 3/2023 (JR), datë 06.02.2023.*

grykues kanë plotësuar deklaratat për mungesë konflikti interesi me subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nga Komisioni nuk i është respektuar parimi i sigurisë juridike, parimi i diskrecionit, proporcionalitetit dhe objektivitetit në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës. Në Komision shpenzimet për udhëtimet jashtë Shqipërisë janë llogaritur nga një metodologji e përcaktuar nga ILDKPKI-ja. Nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 nuk rezulton se Komisionit i është dhënë e drejta me ligj të ushtrojë diskrecionin në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, sipas vlerësimit të tij. Sa i përket parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit nga Komisioni nuk është marrë për bazë rast pas rasti dhe vit pas viti struktura e buxhetit të familjes, duke konsideruar të njëjta shpenzimet e fëmijës së sapolindur me një të rritur, pa bërë diferencim burra, gra, studentë, pensionistë, vendi i të jetuarit, mënyra si ushqehet personi, nevojat e tij, etj. Sipas subjektit të rivlerësimit mënyra e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës për të dhe familjen e tij duhet të ishte 66% e të ardhurave bujqësore për periudhën 1993-1999, ndërsa për periudhën 2000-2005 duhet të përlllogariten sipas përcaktimeve të INSTAT-it për rajonin malor.

15.1 Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se Komisioni ka kryer përlllogaritjet për shpenzimet e jetesës, duke u bazuar në dokumente zyrtare të institucioneve shtetërore, siç është ILDKPKI dhe INSTAT. Lidhur me pretendimin për shpenzime të larta jetese të përlllogaritura në Komision, nga kontrolli që Kolegji ushtroi në analizën financiare të kryer nga Komisioni vlerësohet i drejtë qëndrimi i Komisionit, i cili ka përlllogaritur shpenzime jetese për subjektin e rivlerësimit për një familje prej 4 personash, sipas shkresave të përcjella në ILDKPKI nga INSTAT, standard i cili gjen zbatim gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit.

Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e pasurisë

16. **Lidhur me pasurinë shtëpi banimi, ndodhur në fshatin {***}**, Njësia Administrative Mollas, Bashkia Kolonjë, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk i është kaluar barra e provës për pasaktësi në deklaram lidhur me pasurinë shtëpi banimi në {***}, pasi në rezultatet e hetimit, Komisioni ka konkluduar se [...] subjekti ka deklaruar saktë pasurinë shtëpi banimi të ndodhur në {***} të Kolonjës, por ka mungesë dokumentacioni ligjor për të provuar pronësinë e kësaj banese, ndërsa në vendim ka konkluduar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka paraqitur dokumentacion për të provuar përbërjen familjare, vendlindjen dhe vendbanimin e prindërve të tij, pasi pronat e fshatit {***}, Njësia Administrative Mollas, Bashkia Kolonjë, nuk janë regjistruar, ndaj është e pamundur të paraqitet dokumentacion lidhur me pronësinë e kësaj pasurie. Subjekti pretendon se mosregjistrimi i pronës nuk ka ardhur për fajin e tij, por të institucioneve shtetërore, duke pretenduar se nuk është regjistrimi i pasurisë që të bën pronar, pasi pronësia është një gjendje fakti. Në përfundim të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka deklaruar saktë pasurinë shtëpi banimi e trashëguar nga babai, ndodhur në {***} të Kolonjës.

16.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: “Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion që justifikon vërtetësinë e deklarimeve të tij në lidhje me faktin se kjo shtëpi ka qenë në pronësi të babait të tij. Pronësia mbi këtë shtëpi ngelet vetëm

në nivel deklarativ nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016”.

16.2 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtëpi banimi në fshatin {***}, Njësia Administrative Mollas, Bashkia Kolonjë, me dy kate e përbërë nga 4 dhoma, dy korridore, me sip. 100 m², në secilin kat, si dhe aneks ngjitur kësaj banese. Shtëpia ndodhet mbi një sipërfaqe trualli prej 350 m². Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar se kjo shtëpi është trashëguar nga babai. Vlera e pasurisë: e padeklaruar, pasi shtëpia rezultoi e pavlerësuar. Pjesa takuese: 50 % në bashkëpronësi me nënën. Subjekti ka shpjeguar në këtë deklaratë se është banesë e ndërtuar para viteve 1970 e trashëguar nga babai.

Në DIPP-në e vitit 2003 në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar pasurinë shtëpi banimi, 2-katëshe, e përbërë nga 4 dhoma, 2 korridore dhe aneks, ndërsa mënyra e fitimit të pronësisë, e trashëguar nga babai dhe ende e paregjistruar në ZVRPP-në Kolonjë, pasi ndodhet në proces regjistrimi (zonë e pamenaxhuar). Është e pavlerësuar. Pjesa takuese së bashku me nënën, secili me 50 %.

16.3 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të depozitohet dokumentacioni provues në lidhje me pronat e trashëguara nga babai, në përgjigje të së cilave më datë 17.02.2020, subjekti ka sqaruar se ka të trashëguar një shtëpi banimi dykatëshe me mur guri, me katër dhoma, dy korridore dhe aneks ngjitur banesës. Subjekti ka shpjeguar se për këtë pronë nuk ka dokumentacion tjetër përveç Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim “AMTP”), pasi tokat dhe banesat e fshatit {***} janë ende të paregjistruara.

16.4 Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision AMTP-në nr. {***}, datë 13.04.1994, sipas të cilit i jepet në pronësi familjes së T. I. S. gjithsej 34.150 m² tokë bujqësore, nga e cila 31.000 m² arë, 2.800 m² pemëtore dhe 350 m² truall. Toka është përfituar, sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën” (në vijim “ligji nr. 7501/1991”). Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision vërtetimin⁹ e lëshuar nga Zyra Vendore e AShK-së Kolonjë, sipas të cilit vërtetohet se pranë kësaj zyre gjendet e depozituar AMTP-ja me nr. {***}, datë 13.04.1994, në emër të z. T. I. S. (babai i subjektit), nga fshati {***}. Më tej, në vërtetim sqarohet se ky dokument, si të gjitha AMTP-të e fshatit {***} të Bashkisë Kolonjë, nuk është i regjistruar pranë Zyrës Vendore të AShK-së Kolonjë, për arsye se nuk ka përfunduar azhurnimi dhe regjistrimi fillestar për zonën kadastrale nr. {***}, fshati {***}. Po kështu, subjekti ka paraqitur edhe vërtetimin negativ nr. {***} prot., datë 18.02.2020, të AShK-së, Kolonjë, me anë të të cilit konfirmohet se për fshatin {***} nuk kanë të regjistruar asnjë pasuri të paluajtshme.

16.5 Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasurinë shtëpi e trashëguar nga babai, ndodhur në {***} të Kolonjës, duke i kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi ka mungesë dokumentacioni ligjor për të vërtetuar pronësinë e kësaj banese. Ndërkohë Komisioni ishte vënë në dijeni nëpërmjet dokumentacionit, sjellë nga subjekti i rivlerësimit se AShK-ja Kolonjë nuk disponon asnjë dokumentacion për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, pasi ishte një proces që nuk ka filluar për fshatin {***}, si dhe duke specifikuar edhe zonën kadastrale ({***}) në të cilën gjendet prona (tokë bujqësore) e subjektit të rivlerësimit e fituar nëpërmjet AMTP-së.

⁹ Vërtetim nr. {***}, datë 17.04.2020.

16.6 Subjekti i rivlerësimit, mbi bazën e dokumentacionit të dërguar në Komision dhe që gjendet i administruar në dosje, ka provuar se familja e tij ka marrë tokë bujqësore, sipas ligjit nr. 7501/1991, dokumentuar me AMTP-në përkatëse, të cilën e disponon, por që e ka të paregjistruar në AShK-në e Kolonjës, për shkak se siç konkludohet edhe nga vërtetimet e lëshuara nga kjo zyrë, për fshatin {***} nuk ka asnjë pronë të paluajtshme të regjistruar, pasi procesi i azhurnimit nuk ka përfunduar dhe nuk i është nënshtruar regjistrimit fillestar. Ndërkohë subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën e para fillimit të detyrës të vitit 2003, shtëpinë e banimit dhe tokën bujqësore, por edhe në deklaratën *vetting*, si rrjedhojë mosdokumentimi i regjistrimit ka ardhur për shkak të arsyeve objektive dhe jo për neglizhencën e subjektit të rivlerësimit. Në kuadër të parimit të objektivitetit, problematikat në administrimin e dokumentacionit nga organet shtetërore nuk duhet të rëndojnë mbi subjektin e rivlerësimit, për sa kohë nga procesi i rivlerësimit nuk u evidentuan gjetje në drejtim të veprimeve të qëllimshme nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me sa më sipër.

16.7 Në përfundim të këtij shkakut ankimi, lidhur me shtëpinë e banimit të ndodhur në fshatin {***}, Kolonjë, të cilës nuk i është kryer regjistrimi fillestar dhe nuk është hedhur ende në sistemin kadastral, ashtu si të gjitha pasuritë e paluajtshme të këtij fshati që nuk i janë nënshtruar regjistrimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbajë përgjegjësi për çështje që varen nga institucionet shtetërore. Neni D i Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar se subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë me saktësi ose plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur, në funksion të vazhdimit të qëndrimit në detyrë. Konkretisht, plotësimi me saktësi dhe vërtetësi i deklaratës *vetting* ka rëndësi për zbatimin e detyrës të kuadrit ligjor (neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016¹⁰) dhe nënligjor (Udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i ILDKPKI¹¹-së). Këto rregullime kërkojnë që subjektet e rivlerësimit të deklarojnë saktësisht dhe plotësisht pasurinë, të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të saj. Në rastin konkret, subjekti ka deklaruar me saktësi pasurinë e tij dhe të personave të lidhur, siç ka konkluduar edhe Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, por për shkaqet e shpjeguara më sipër ishte në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion mbi pronësinë e kësaj pasurie dhe, për këtë arsye, gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. *Si rrjedhojë, pretendimi i ngritur nga subjekti i rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit për pasaktësi në deklarimin e kësaj pasurie gjendet i bazuar.*

- 17. Lidhur me pasurinë tokë bujqësore me sip. 34.150 m², ndodhur në fshatin {***}, Bashkia Kolonjë, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e arritura nga Komisionit bazohen në akte të pavërteta dhe nuk i përgjigjen realitetit të ndodhur, si dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ. Në lidhje me konkluzionin e Komisionit se subjektit të rivlerësimit**

¹⁰ Neni 33, pika 5, germa "a" e ligjit parashikon: "[...] a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin [...]".

¹¹ "Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" – pika 17. "Deklarimi i gjendjes "cash" do të njihet si i tillë në konceptin e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, deri në kufirin e shumës 1.5 milionë lekë. Shumat më të mëdha duhet të formalizohen në sistemin bankar, përpara dorëzimit të deklaratës në ILDKPKI, duke bashkëlidhur në çdo rast vërtetimin bankar për këtë veprim".

i përket 1/7 pjesë takuese e kësaj pasurie dhe se kjo mbeti në nivel deklarativ, pasi nuk u provua me dokumentacion ligjor nga subjekti i rivlerësimit, ky i fundit pretendon se Komisioni padrejtësisht nuk ka vlerësuar shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e paraqitur prej tij. Subjekti pretendon se me deklaratat noteriale lëshuar nga motrat e tij ka provuar se ato kanë hequr dorë nga pronësia e përfitur sipas AMTP-së. Subjekti pretendon se është në të drejtën e secilit që me vullnet të lirë dhe të pavesuar të heqë dorë në mënyrë vullnetare nga pasuritë që përfitojnë/zotërojnë. Sipas subjektit, familja bujqësore është një organizim që ndryshon me kalimin e kohës, pasi anëtarët nuk janë të përjetshëm dhe marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve ndryshojnë, si dhe motrat për shkak të martesës së tyre nuk i përkasin më familjes bujqësore të origjinës, duke qenë anëtare të familjes bujqësore të bashkëshortëve respektivë.

17.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: “[...]subjekti i rivlerësimi nuk ka paraqitur dokumentacion që justifikon vërtetësinë e deklaratimeve të tij në lidhje me posedimin e 32 dynymëve tokë bujqësore dhe, për rrjedhojë, për të ardhurat e përfituara nga frutat e kësaj toke, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016”.

17.2 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se zotëron tokë bujqësore me sip. 34.150 m², përfitur me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, ku përcaktohet 350 m² truall + 31.000 m² toke “arë” dhe 2.800 m² “pemëtore”, e pasqyruar në AMTP-në nr. {***}, datë 13.04.1994, në emër të babait të subjektit T. S. (nga kjo sipërfaqe 2.150 m² i përket motrës së martuar të subjektit M. S. (M.). Pjesa takuese: 25 %, në bashkëpronësi me familjen. Burimi i krijimit: përfitim nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 (me AMTP-në nr. {***}, datë 13.04.1994). E paregjistruar në ZVRPP-në Kolonjë, pasi ndodhet në proces regjistrimi (zonë e pamenaxhuar).

Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar tokë bujqësore 32 dynymë, me pjesë takuese 25%, në fshatin {***}, Kolonjë, fituar me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”.

17.3 Referuar dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se ZVRPP-ja Kolonjë ka informuar¹² Komisionin se shtetasit Hysen Saliko, M. S., L. S. etj., janë nga fshati {***}, pronat e të cilëve nuk janë hedhur ende në sistem dhe, për rrjedhojë, nuk disponojnë informacion. Në sistemin hipotekor nuk kanë të regjistruar pasuritë e paluajtshme. AShK-ja Kolonjë¹³ informon se mbështetur në kërkesën e subjektit Hysen Saliko ka lëshuar vërtetimin nr. {***} prot., datë 17.04.2020, në të cilin sqarohet se gjendet e depozituar pranë Zyrës Vendore të AShK-së Kolonjë, AMTP-ja nr. {***}, datë 13.04.1994, në emër të T. S. dhe se AMTP-të e fshatit {***} nuk janë të regjistruara për arsye se nuk ka përfunduar azhurnimi dhe regjistrimi fillestar për zonën kadastrale {***}, {***}, Kolonjë.

17.4 Në lidhje me pasurinë e përfitur nga ligji nr. 7501/1991, pasqyruar në AMTP-në e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është përfitues në masën 25 %. Për këtë arsye iu kërkua nga Komisioni të japë shpjegime në lidhje me masën 25 % të tokës se përfitur, kur familja bujqësore përbëhej nga 7 anëtarë, sipas certifikatës së përbërjes familjare të datës

¹² Me shkresën nr. {***} prot., datë 11.03.2019.

¹³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 12.05.2020.

01.08.1991. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e datës 30.04.2020 ka shpjeguar se: “Në deklaratën vetting kam shprehur se përfitoj 25 %, duke iu referuar përfitim të të ardhurave nga toka bujqësore. Kjo për faktin se që nga viti 2003 kur kemi bërë deklarin e parë dhe deri më tash, pas vdekjes së babait, ne në familje kemi mbetur 4 persona që kemi përfutuar tokë bujqësore, konkretisht M., Hysen, L. dhe I. Saliko. Megjithatë për këtë fakt në çdo deklarin që kam bërë kam përdorur shprehjen me “familjen”. Është e vërtetë se në datën 01.08.1991 në përbërje të familjes ne kemi qenë shtatë anëtarë, ku në përbërje përfshihen edhe 2 motrat S. dhe M., por motra ime S. është martuar faktikisht më 08.09.1991 dhe ligjrisht në datën 07.05.1992. Ajo që në momentin e martesës “de facto” ka hequr dorë nga pasuria dhe, për këtë fakt, për asnjë moment nuk ka poseduar, përdorur apo gëzuar frutat e tokës bujqësore. Kjo dorëheqje është konfirmuar edhe pas vdekjes së babait ku ajo dhe motrat e tjera (A dhe P) nuk kanë kërkuar të përfitojnë nga trashëgimia e babait të tyre (atit tim T.). Ndërsa për motrën tjetër M. S. e kam deklaruar që është përfutuese e tokës bujqësore. Gjithsesi, posedimi dhe gëzimi është gjendje fakti, prona posedohet dhe gëzohet prej familjes sime me 4 persona. Ndërsa motrës M. S. (M.) që në momentin e martesës i kemi lënë në përdorim 2,15 dynym tokë bujqësore (ngastrën më të mirë) dhe 2,8 dynym pemëtoren (me arra) gjithsej 4,95 dynym fakt të cilën e kam deklaruar dhe në deklaratën vetting”.

17.5 Komisioni i ka kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit nëse ka bërë ndonjë aplikim për regjistrimin e pasurive të trashëguara nga babai. Subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet e datës 17.02.2020, ka sqaruar se në lidhje me këto prona nuk kanë dokumentacion tjetër përveç AMTP-së, pasi siç ka sqaruar edhe më parë, tokat dhe banesat e fshatit janë ende të paregjistruara. Subjekti ka depozituar dokumentacion ligjor justifikues për të mbështetur deklarin e tij gjatë hetimit administrativ, të cilat konsistojnë në vërtetimin negativ të lëshuar nga ZVRPP-ja Kolonjë, me sqarimin se për këto toka nuk është bërë regjistrimi, ndaj nuk ka pasur asnjë mundësi për të aplikuar për regjistrim, si dhe vërtetimin negativ nr. {***} prot., datë 18.02.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Kolonjë.

17.6 Nga faktet e rezultuara, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me mungesën e dokumentacionit ligjor justifikues për të vërtetuar pronësinë mbi këtë tokë, pjesën takuese dhe aktin e trashëgimisë. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi të njëjtat situata, ashtu si në shpjegimet e dhëna ndaj pyetësorëve të Komisionit, si dhe nuk arriti të sjellë asnjë dokumentacion shtesë nga ato që vërtetonin se nuk kishte sistem regjistrimi të pronave për fshatin ku ndodhej toka bujqësore e subjektit të rivlerësimit, të cilën e kishte në bashkëpronësi me familjarët e tjerë. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka deklaruar se dëshminë e trashëgimisë nuk e ka çelur në kohë, pasi nuk i është dashur. Subjekti ka shpjeguar se për ndonjë nevojë të ngutshme ka përdorur dëshminë e trashëgimisë së të ndjerit xhaxhait të tij, të lëshuar me vendimin nr. {***}, datë 31.07.1995, të Gjykatës së Rrethit Kolonjë, ku në vend të babait të subjektit kanë hyrë me zëvendësim trashëgimtarët e tij M. S., Hysen Saliko dhe M. S. (pasi motrat A., V. dhe S. S. kanë hequr dorë nga trashëgimia në momentin e lëshimit të kësaj dëshmie, dorëheqje që është bërë në momentin e lëshimit të saj para gjykatës).

17.7 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar bashkë me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit aktin e

lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë ligjore të lëshuar nga noterja F. L., pranë Dhomës së Noterisë Korçë, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.06.2020. Sipas këtij akti rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit, i ndjeri T. S., ka vdekur më datë 30.10.1994, duke lënë pas bashkëshorten e tij dhe pesë fëmijët. Në aktin e trashëgimisë ligjore është cituar, gjithashtu, se fëmijët e të ndjerit, të cilit po i çelej trashëgimia ligjore, A. R.¹⁴, S. B.¹⁵ dhe V. L.¹⁶, kanë hequr dorë nga kjo trashëgimi nëpërmjet deklaratave noteriale. Në përfundim noterja ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit, duke përcaktuar trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë M. S. (nëna e subjektit), Hysen Saliko dhe M. M. (motra e subjektit), të cilët trashëgojnë nga 1/3 pjesë takuese secili.

17.8 Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktësisht dhe në mënyrë të plotë të pasurisë së tij dhe personave të lidhur për burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra, shkaku apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj. Në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të situatës faktike për këtë pasuri, atë të posedimit të ¼ të saj, ndërkohë që sipas AMTP-së i takon 1/6 pjesë takuese (anëtarët e familjes bujqësore që janë gjallë), për shkak të qenies në kushtet kur bashkëpronarët nuk mund të bëjnë veprime juridike lidhur me tjetërsimin e pronës (nga motrat), për shkak të pamundësisë për ta regjistruar në regjistrat e kadastrës së Kolonjës, duke ditur edhe vullnetin e motrave për të mos u përfshirë në këto pasuri. Si rrjedhojë, po t'i referohemi situatës faktike, subjekti ka deklaruar me saktësi e vërtetësi pasurinë që gëzon e posedon *de facto*, por nuk mund ta disponojë lirisht për shkak të mungesës së regjistrimit. Në këto kushte, në vlerësimin e Kolegjit, kjo pasaktësi e rezultuar si rrjedhojë e mospërputhjes së gjendjes së dokumentacionit me gjendjen faktike, nuk e ngre pasaktësinë në nivelin e vendosjes së masës disiplinore për subjektin e rivlerësimit.

18. ***Lidhur me të ardhurat e realizuara nga bujqësia***, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se ka provuar që të ardhurat e realizuara nga ferma bujqësore, jo vetëm që janë të ligjshme, por edhe në masën e atyre vlerave të deklaruara ndër vite në DIPP-të përkatëse. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në asnjë rregullim ligjor nuk parashikohet detyrimi i bujkut privat për të deklaruar të ardhurat nga bujqësia në organet tatimore dhe për më tepër detyrimi për të paguar tatim për këto të ardhura. Vetëm pas vitit 2015, pajisja me NIPT fermerëve është fakultative dhe bëhet me vullnetin e tyre me qëllimin e vetëm për të përfituar nga formula e rimbursimit të TVSh-së, pasi objekt taksimi ka qenë vetëm sipërfaqja e tokës dhe jo të ardhurat e gjeneruara nga toka bujqësore apo prodhimet blegtorale. Sipas subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga sa konkludon Komisioni, ka provuar jo vetëm që bashkëshortja si e vetëpunësuar në bujqësi ka ushtruar aktivitet bujqësor (së bashku me anëtarët e tjerë të familjes bujqësore) dhe është marrë me bletari e pemëtari, por ka paraqitur mjaftueshëm dokumentacion për të ardhurat e përfituara nga bujqësia, për periudhën 1993-2015, të deklaruara në DIPP-të ndër vite dhe në deklaratën *vetting*. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se bashkëshortja e tij ka paguar

¹⁴ Ka hequr dorë nga trashëgimia me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.05.2020.

¹⁵ Ka hequr dorë nga trashëgimia me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.05.2020.

¹⁶ Ka hequr dorë nga trashëgimia me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.05.2020.

rregullisht kontributet për sigurimet shoqërore nga viti 1993 deri në vitin 2012 si e vetëpunësuar në bujqësi, pagesë e cila është shoqëruar me pagesën e taksës së tokës bujqësore.

18.1 Konkluzionet e Komisionit për këto të ardhura: *“Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave, duke mos vërtetuar tokën në pronësi/përdorim, si dhe nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues pagimin e tatimit mbi të ardhurat e krijuara nga aksesorët dhe frytet e tokës bujqësore, pemëtarisë dhe bletarisë. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këto të ardhura për periudhën 1993 – 2015, në shumën 13.500.000 lekë, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016”.*

18.2 Duke qenë se pasuritë, likuiditetet *cash* dhe në bankë, si dhe pasuri të tjera të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit kanë si burim krijimi, kryesisht të ardhurat nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria, Komisioni analizoi të ardhurat nga këto aktivitete për vitet 1993 – 2015.

Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën prej 15.532.000 lekësh të ardhura nga ferma bujqësore, pemëtaria dhe bletaria në pronësi të familjes që ndodhet në fshatin {***}, Bashkia Kolonjë, për periudhën 1992 – 2016 (toka bujqësore 29 dynym, 2.8 dynym pemëtoare dhe nga mbarështimi i 40-60 koshere bletë nga viti 1992 e në vazhdim).

18.3 Në deklaratën e parë të pasurisë në vitin **2003**, subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* në vlerën 2.000.000 lekë në familje, me burim krijimi të ardhura nga paga e toka bujqësore.

Në DIPP-në e vitit **2004**, subjekti i rivlerësimit deklaroi të ardhura nga toka bujqësore dhe bletaria 450.000 lekë [...]. Toka bujqësore në fshat dhe ferma me bletë në fshat.

Në DIPP-në e vitit **2005**, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e pasurive krijimin e një depozite në shumën 1.550.058.5 lekë, me përshkrimin: *“Lekë cash të depozituara në bankën “Raiffeisen Bank” në depozitat nr. {***}, {***} dhe {***}, në emrin tim dhe të nënës. Shuma është e krijuar nga kursimet e viteve 2004-2005 e të ardhurat e këtyre viteve nga paga e të ardhurat nga ferma bujqësore e blegtorale”.*

Në rubrikën e të ardhurave, subjekti deklaroi 700.000 lekë të ardhura me përshkrimin: *“Të ardhura nga toka bujqësore pemëtari e bletari e ndodhur në fshatin {***}, Kolonjë”.*

Në DIPP-në e vitit **2006**, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e pasurive, krijimin e një depozite në shumën 484.454,5 lekë me përshkrimin: *“Lekë cash të depozituara në “Raiffeisen Bank” në depozitën me nr. 347536, shumë e ardhur nga kursimet e vitit 2006”.*

“Gjendje cash në familje e fituar nga kursimet e të ardhurave nga pagat dhe ferma bujqësore blegtorale gjatë vitit 2006, vlera 800.000 lekë”.

Në rubrikën e të ardhurave, subjekti deklaroi shumën 750.000 lekë të ardhura me përshkrimin: *“Të ardhura nga ferma bujqësore bletari-pemëtari në fshatin {***}, Kolonjë, viti 2006”.*

Në DIPP-në e vitit **2007**, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e pasurive krijimin e shumës 1.600.000 lekë *cash* me përshkrimin: *“Lekë cash në familje të fituara nga kursimet, të ardhurat nga pagat, ferma bujqësore-blegtorale gjatë vitit 2007”.*

Në rubrikën e të ardhurave subjekti ka deklaruar 950.000 lekë të ardhura nga toka bujqësore dhe puna e bletëve nga familja, ndodhur në fshatin {***}, në Kolonjë.

Në DIPP-në e vitit **2008**, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e pasurive krijimit e 600.000 lekë *cash* me përshkrimin: *“Lekë cash në familje të fituara nga kursimet e të ardhurave nga paga, ferma bujqësore e bletari gjatë vitit 2008”*.

Në rubrikën e të ardhurave, subjekti ka deklaruar 800.000 lekë të ardhura nga toka bujqësore, pemëtaria e bletaria e familjes, ndodhur në fshatin {***}, të rrethit Kolonjë.

Në DIPP-në e vitit **2009**, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e pasurive krijimit e 1.300.000 lekë *cash*, me përshkrimin: *“Lekë cash në familje të fituara nga kursimet e të ardhurave nga paga, ferma bujqësore e bletari gjatë vitit 2009”*.

Në rubrikën e të ardhurave, subjekti ka deklaruar 800.000 lekë të ardhura nga toka bujqësore, pemëtaria e bletaria e familjes, ndodhur në fshatin {***}, të rrethit Kolonjë.

Në DIPP-në e vitit **2010**, në rubrikën e të ardhurave, subjekti ka deklaruar 1.800.000 lekë të ardhura nga toka bujqësore, pemëtaria e bletaria e familjes, ndodhur në fshatin {***}, të rrethit Kolonjë.

Në DIPP-në e vitit **2011**, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e pasurive krijimit e 1.600.000 lekë *cash*, me përshkrimin: *“Gjendje para cash nga kursimet dhe të ardhurat nga ferma bujqësore dhe bletaria”*.

Në rubrikën e të ardhurave, subjekti ka deklaruar 1.200.000 lekë të ardhura nga toka bujqësore, pemëtaria e bletaria e familjes, ndodhur në fshatin {***}, të rrethit Kolonjë.

Në DIPP-në e vitit **2012**, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e pasurive krijimit e 1.600.000 lekë *cash*, me përshkrimin: *“Shtuar gjendje para cash nga kursimet dhe të ardhurat nga ferma bujqësore dhe bletaria e familjes(të nënës) për vitin 2012”*.

Në rubrikën e të ardhurave, subjekti ka deklaruar 1.100.000 lekë të ardhura nga toka bujqësore, pemëtaria e bletaria e familjes, ndodhur në fshatin {***}, të rrethit Kolonjë.

Në DIPP-në e vitit **2013**, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e pasurive krijimit e 1.600.000 lekëve *cash*, me përshkrimin: *“Shtuar gjendje cash nga kursimet dhe të ardhurat nga ferma bujqësore dhe bletaria e familjes(administruar prej nënës) për vitin 2013”*.

Në rubrikën e të ardhurave, subjekti ka deklaruar 1.100.000 lekë të ardhura nga toka bujqësore, pemëtaria e bletaria e familjes, ndodhur në fshatin {***}, të rrethit Kolonjë.

Në DIPP-në e vitit **2014**, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e të ardhurave 1.100.000 lekë të ardhura nga toka bujqësore, pemëtaria e bletaria e familjes, ndodhur në fshatin {***}, të rrethit Kolonjë.

Në DIPP-në e vitit **2015**, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e të ardhurave 1.000.000 lekë të ardhura nga toka bujqësore, pemëtaria e bletaria e familjes, ndodhur në fshatin {***}, të rrethit Kolonjë.

Në DIPP-në e vitit **2016**, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e pasurive krijimit e 300.000 lekë *cash* me përshkrimin: *“Gjendje cash në shtëpi, nga kursimet e familjes gjatë vitit 2016”*.

Në rubrikën e të ardhurave, subjekti ka deklaruar 1.575.136 lekë të ardhura nga toka bujqësore, pemëtaria e bletaria e familjes, në fshatin {***}, të rrethit Kolonjë.

18.4 Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit është pyetur nga Komisioni që të shpjegojë dhe të dokumentojë të ardhurat e krijuara nga bletaria për çdo vit që nga viti 1992, ku të specifikohen dhe dokumentohen: (i) shitjet në vlerë dhe në sasi të produkteve; (ii) çmimet e shitjes së produkteve; (iii) numri i koshereve të bletëve sipas viteve dhe kostot e blerjes së tyre; (iv) shpenzimet për rritjen/mjekimin/ruajtjen/vjeljen e tyre, etj.; (v) shpenzimet për

ambalazhimin e produkteve; (vi) sasinë në litra e prodhuar për koshere/bletë në vit. Në përgjigje të pyetësorit të datës 19.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Si bazë për të shtuar tufën e bletëve ka shërbyer përfitimi nga shpërbërja e ish-koperativës bujqësore të dy krerëve bletë në vitin 1991. [...] Në lidhje me sasinë e prodhuar nga një krerë bletë varion sipas viteve, por që nuk ka qenë më e pakët se 12 litra (ose 16 kg) dhe që varion deri në 18 litra (ose 24 kg). Gjithashtu, nga viti 2010 deri në vitin 2016 nga numri total i bletëve në prodhim, 410 krerë janë përdorur për prodhim qumësht mëme. Nga çdo krerë kemi marrë nga 10 – 14 flakonë (10 gram/flakoni). Çdo flakon shitet 6.000 deri në 10.000 lekë (600-1.000 lekë grami). Edhe gjatë viteve 1994 deri në 2010 kemi përdorur për qumësht çdo vit dy krerë, nga të cilat kemi marrë nga 20 flakonë, por që shumicën e kemi përdorur për nevojat e familjes dhe pjesën tjetër e kemi shitur dhe të ardhurat janë përdorur për mirëmbajtjen e banesës. Për vitet 2010 – 2016 shitjet janë të evidentuara në mandat arkëtimi të nënshkruar nga blerësit [...]”*

18.5 Subjekti i rivlerësimit, për të mbështetur deklaratimet e tij, gjatë hetimit administrativ ka depozituar vërtetimin nr. {***} prot., datë 20.11.2019, lëshuar nga Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Mollas, që vërteton se z. T. I. S., ish-banor i fshatit {***}, në bazë të ligjit 7501/1991, ka përfutur sipërfaqen 33.800 m², tokë bujqësore dhe se janë paguar taksat e tokës dhe taksat e ndërtesës për vitet nga 2004 – 2019 pranë kësaj njësie, nga M. dhe Hysen Saliko. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, gjithashtu, vërtetim (për të vetëpunësuarit në bujqësi) nr. {***} prot., datë 07.10.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, Agjencia Kolonjë, sipas të cilit vërtetohet se bashkëshortja e tij, L. Xh. S., ish-banore e Komunës Mollas, figuron si e vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993, në regjistrin themeltar të të vetëpunësuarve në bujqësi dhe se ka paguar rregullisht kontributet për periudhën 1993 – 2012. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ortofoto të shtëpisë së ndodhur në fshatin {***} (printim i datës 10.12.2019), mandatpagesa për produktet e shitura, mjaltë, grurë, mollë, etj., si dhe disa deklarata me shkrim dore për shitje të koshereve të bletëve.

18.6 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, lidhur me mungesën e dokumentacionit ligjor justifikues mbi të ardhurat e përfuturara nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria për vitet 1992 – 2015, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: *“Në lidhje me të ardhurat e siguruar nga bujqësia dhe bletaria, kam pasur një korrespondencë të gjerë me Komisionin dhe kam dhënë një sërë shpjegimesh duke u përprjekur të jem para së gjithash tejet i sigurtë dhe sa më argumentues, njëherazi jam përprjekur të jem sa më i qartë dhe i kuptueshëm. [...] Bashkëshortja dhe nëna si të vetëpunësuar kanë paguar rregullisht sigurimet dhe taksën e tokës (atë që kishin detyrim) dhe janë marrë me punë bujqësie deri në vitin 2007. Më pas janë marrë kryesisht me shërbimet ndaj pemëtarisë dhe kopshtit për produktet për konsum familjar. Sikundër theksova dhe më sipër, bletaria ka qenë dhe është një pasion i trashëguar nga babai dhe shumë fitimprurës. Mjalti është një produkt shumë i kërkuar në treg dhe shpesh herë nuk kam arritur të plotësoja kërkesat e miqve e kolegëve për këtë produkt. Këtë fakt të njohur mund t’ua provojnë mjaft kolegë të mi dhe miq, emrat e të cilëve po ua jap, të cilët me kënaqësi vijnë të dëshmojnë këtë fakt. Arrat janë, gjithashtu, një frut mjaft i kërkuar në treg dhe, gjithashtu, i kushtueshëm, i shtrenjtë në shitje. Shpenzimet për to janë të pakta ose minimale. Mollët kanë*

*prodhim aq të lartë sa nuk arrijmë t'i shesim dhe i hanë dhe kafshët. Ju kam provuar që kam lindur dhe kam jetuar në fshatin {***}, pa ndërprerje deri rreth vitit 2007. Edhe sot kam shumë lidhje të ngushta, pasi kam shtëpinë e trashëguar nga babai dhe nëna kryesisht jeton atje edhe sot pasi kujdeset sa mundet për kopshtin rreth shtëpisë dhe me bletët aq sa mundet. Ju kam provuar që nuk e kam braktisur vendlindjen time as sot që flasim pasi kam atje nënën, tokën, shtëpinë, pemët dhe si pjesë të familjes edhe bletët. Për këto kërkoj të thërrisni si dëshmitar jo vetëm kufitarët, por dhe banorë të tjerë të fshatit që t'ju dëshmojnë të gjithë sa unë kam deklaruar. Ju kam sjell vërtetime nga kryepleqtë e fshatit ndër vite. Kam deklaruar çdo vit të ardhurat e realizuara nga këto produkte bujqësore, pemëtari dhe bletari [...]”.*

18.7 Bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes, Kolegji vlerësimin e të ardhurave nga bujqësia e analizoi në dy aspekte:

- i) A e ka realizuar subjekti i rivlerësimit sasinë e të ardhurave të deklaruara si të krijuara nga aktiviteti i tij bujqësor e bletar ndër vite?
- ii) Të ardhurat e deklaruara si të realizuara nga bujqësia nga viti 1993-2016, a janë të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës?

18.8 Lidhur me pikën (i) të paragrafit më sipër, analizojmë dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ, si dhe dokumentacionin që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni rezulton se fillimisht këto të ardhura janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI, duke filluar nga viti 2003 dhe deri në deklaratën *vetting*, në të cilën ka deklaruar një total prej 15.525.136 lekësh.

18.9 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision aktin e ekspertimit të hartuar nga eksperti N. T.. Sipas përmbajtjes së këtij akti, nga eksperti është kryer përlllogaritja e fitimit në lekë të produkteve sipas pyetjeve të drejtuara nga subjekti i rivlerësimit që konsistojnë në: (1) sa kuintalë grurë është prodhuar në 1 ha tokë, si dhe sa janë të ardhurat nga ky prodhim nga viti 1992-2007, në përgjigje të së cilës fitimi *neto* nga shitja e grurit të mbjellë në parcelat e familjes së subjektit të rivlerësimit ishte në vlerën 1.756.550 lekë; (2) sa janë të ardhurat që sigurohen nga 3 dynym tokë e mbjellë me fasule për çdo vit nga viti 1992-2007 në përgjigje të së cilës, fitimi *neto* nga prodhimi i fasuleve në tokën bujqësore të familjes së subjektit të rivlerësimit mund të ishte në vlerën 727.560 lekë; (3) sa janë të ardhurat që sigurohen nga 1 dynym tokë e mbjellë me patate për çdo vit nga viti 1992-2007, në përgjigje të së cilës nga prodhimi i patateve në tokën bujqësore të familjes së subjektit të rivlerësimit mund të ishte në vlerën 757.700 lekë; (4) sa janë të ardhurat që sigurohen nga 1 dynym tokë e mbjellë me perime për çdo vit, duke filluar llogaritja nga viti 1992-2007, në përgjigje të së cilës rezultoi se nga prodhimi i kulturave bujqësore perimore në tokën bujqësore të familjes së subjektit të rivlerësimit mund të ishte në vlerën 457.700 lekë; (5) sa janë të ardhurat që sigurohen për 400 rrënjë mollë të kultivuara që nga viti që kanë hyrë në prodhim deri në vitin 2016, në përgjigje të së cilës rezultoi se nga prodhimi i mollëve në tokën bujqësore të familjes së subjektit të rivlerësimit mund të ishte në vlerën 4.840.000 lekë; (6) sa janë të ardhurat që sigurohen nga një krrerë bletë dhe llogaritja të bëhet për çdo vit nga viti 1992-2016, në përgjigje të së cilës eksperti ka përcaktuar se nga të ardhurat nga prodhimet e bletëve vetëm për një koshere të familjes së subjektit të rivlerësimit mund të ishte në vlerën 480.715 lekë; (7) sa gramë ose sa flakonë qumësht blete mund të

sigurohen në një vit nga 1 krerë bletë, në përgjigje të së cilës eksperti ka përcaktuar se çdo krerë bletë arrin 150-200 gram qumësht dhe 5000-10000 lekë flakoni me 10 gramë. Për të gjitha këto, eksperti agronom është përgjigjur duke nxjerrë të ardhurat *bruto* dhe *neto* të krijuara nga bujqësia dhe bletaria. Sipas aktit të ekspertimit këto të ardhura të përlllogaritura nga eksperti agronom përbëjnë një total në shumën 8.839.525 lekë.

18.10 Kolegji vëren se akti i ekspertimit i referohet një numri shumë më të madh të llojeve të prodhimeve bujqësore, të cilat janë kërkuar nga vetë subjekti i rivlerësimit për t'u përlllogaritur nga eksperti, situatë që krijon bindjen se është realizuar qëllimisht nga eksperti në këtë mënyrë, për ta favorizuar subjektin e rivlerësimit. Për më tepër, akti i ekspertimit është në kundërshtim me atë që është deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit, për arsytet se: (i) në raportin e tij, eksperti ka bërë përlllogaritjen e fitimeve nga gruri për kultivimin e tij në sipërfaqen 15.000 m² tokë, ndërsa subjekti i rivlerësimit në relacionin sqarues të dorëzuar në ILDKPKI me deklaratën *vetting* nuk ka përmendur kultivimin e drithit nga familja e tij bujqësore; (ii) në ekspertizë është llogaritur si tokë e mbjellë me mollë sipërfaqja 4.000 m² (tabela nr. 5 e aktit të ekspertimit), ndërsa sipas dokumentit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP) totali i tokës pëmishte rezulton në masën 2.800 m². Trupi gjykues vlerëson se ky akt ekspertimi është mbështetur mbi hipoteza për mundësinë e prodhimit të produkteve të ndryshme bujqësore nga toka, bazuar në pyetjet që subjekti i rivlerësimit i ka bërë ekspertit, por nuk provon llojshmërinë dhe sasinë reale të produkteve të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e të ardhurave, nuk referon nëse për prodhimin e produkteve do të ishte e nevojshme një fuqi e caktuar punëtore, efektet e kushteve klimatike në vite të ndryshme, kostot respektive të prodhimit. Për arsytet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se ky akt ekspertimi nuk ka vlerë provuese për pretendimet e subjektit të rivlerësimit.

18.11 Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, ka paraqitur në Komision 226 mandatarkëtime për periudhën nga viti 2010-2016, si dhe fatura tatimore të shitjes së produkteve bujqësore të lëshuara nga nëna e tij për periudhën 2016-2019. Trupi gjykues vëren se mandatarkëtimet për periudhën 2010-2016 janë dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit vetëm në kuadër të hetimit administrativ pranë Komisionit. Rezulton se subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën *vetting* ka depozituar në ILDKPKI më datë 20.01.2017 edhe një relacion sqarues në lidhje me të ardhurat e pretenduara si të siguruara nga ferma bujqësore, pemëtaria dhe bletaria e familjes për vitet 1994 deri në datën 31.12.2016, si dhe disa fatura tatimore shitjeje të vitit 2016, por nuk ka depozituar asnjë nga 226 mandatarkëtimet e sipërcituara, ndërkohë që kishte detyrimin që së bashku me deklaratën *vetting* të depozitonte çdo dokumentacion provues, lidhur me të ardhurat e realizuara ndër vite në zbatim të detyrimit urdhërues të nenit D, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*”. Rezulton se mandatarkëtimet janë paraqitur në Komision së bashku me përgjigjet e pyetësorit të Komisionit datë 19.11.2019. Mandatarkëtimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk janë një dokumentacion zyrtar i hartuar, lëshuar, administruar, regjistruar dhe kontrolluar nga organet tatimore, por rezulton se janë hartuar nga familjarët e subjektit të rivlerësimit, pa pasur përgjegjësi ligjore në raport me administratën tatimore ose ndonjë institucion tjetër shtetëror, duke ngelur në nivelin e një shkrese të thjeshtë private. Në këto

kushte, trupi gjykues nuk krijon bindjen se mandatarkëtimet janë reale dhe as që janë hartuar gjatë viteve 2010-2016, duke i çmuar pa vlerë provuese lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga subjekti i rivlerësimit. Si rrjedhojë e sa më sipër, sasia e të ardhurave të pretenduara të krijuara nga bujqësia dhe bletaria, të deklaruara në vijimësi nga subjekti i rivlerësimit në të gjitha deklaratat periodike në ILDKPKI, nuk u provua me dokumentacion të besueshëm e, si rrjedhojë, nuk u njohën nga trupi gjykues.

18.12 Për të provuar shlyerjen e taksave vendore për tokën bujqësore, subjekti i rivlerësimit depozitoi vërtetimin vërtetim nr. {***} prot., datë 20.11.2019, lëshuar nga Bashkia Kolonjë, që vërteton se z. T. I. S., ish-banor i fshatit {***}, në bazë të ligjit 7501/1991, ka përfituar sipërfaqen 33.800 m², tokë bujqësore dhe se janë paguar taksat e tokës dhe taksat e ndërtesës për vitet nga 2004 – 2019 pranë kësaj njësie, nga M. dhe Hysen Saliko. Nëpërmjet këtij dokumenti, subjekti i rivlerësimit provoi që janë paguar taksat e tokës dhe ndërtesës, por nuk provoi të ardhurat e krijuara nga produktet e kësaj toke.

18.13 Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka krijuar të ardhura të konsiderueshme nga bujqësia e bletaria, duke pretenduar se janë kujdesur nëna dhe bashkëshortja e tij, por nga ana tjetër nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se asnjëri prej tyre nuk ka jetuar vazhdimisht në fshat pas vitit 2007, pasi një sipërmarrje e tillë me të ardhura të vazhdueshme dhe të konsiderueshme kërkon një impenjim të tillë që minimumi familjarët e subjektit të rivlerësimit të jenë në mënyrë të vazhdueshme të lidhur me këtë aktivitet. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, pas transferimit të subjektit të rivlerësimit me punë në Tiranë, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, ka banuar kryesisht në Tiranë, po ashtu edhe nëna e tij, fakt i cili nuk u kontestua asnjëherë nga subjekti i rivlerësimit. Ky fakt mbështetet¹⁷ edhe nga konsumi i energjisë elektrike, sipas faturave të OSHEE-së, ku vërehet se midis viteve 2007 dhe 2015 ka pasur një konsum minimal të energjisë elektrike në shtëpinë e subjektit të rivlerësimit, në {***}.

18.14 Në përfundim të këtij shkakui ankimi, lidhur me të ardhurat e pretenduara të përfituara nga bujqësia e bletaria, në vlerësimin e Kolegjit, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë realizimin e të ardhurave të deklaruara në deklaratat periodike 2003-2015. U provua që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit L. S., figuron si e vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993, në regjistrin themeltar të të vetëpunësuarve në bujqësi dhe ka paguar rregullisht kontributet për periudhën 1993 – 2012. Gjithashtu, u provua se subjekti ka paguar rregullisht taksën e tokës e të ndërtesës, por këto fakte nuk provojnë krijimin e të ardhurave të pretenduara. Si rrjedhojë, Kolegji vlerësoi se të ardhurat nga bujqësia e bletaria, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike 2003-2015, nuk u provuan me dokumente ligjore nga ato të parashikuara nga neni 49 i ligjit nr. 86/2016, duke mbetur në nivel deklarativ, ndaj vlerësohet i drejtë konkluzioni i Komisionit për të mos i përfshirë të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga bujqësia dhe bletaria në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

18.15 Konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues pagimin e tatimit mbi të ardhurat e pretenduara si të krijuara nga toka bujqësore dhe bletaria, të cilin subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi me pretendimin se legjislacioni nuk ka parashikuar detyrim tatimor për këto të ardhura, trupi gjykues nuk e sheh me relevancë për ta

¹⁷ Shkresë e OSHEE-së nr. prot. {***} datë 25.02.2019.

trajtuar, për sa kohë të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, si të krijuara nga bujqësia e bletaria, nuk u provuan. Në përfundim të sa më sipër, Kolegji vlerësoi se të ardhurat nga bujqësia e bletaria, të cilat do të përfshihen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit janë vetëm ato të vitit 2016, krijimi i të cilave u provua me fatura TVSh-je.

19. **Lidhur me apartamentin e banimit me sip. 106,44 m²**, i ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se sa i përket ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga bujqësia si burim i krijimit të pasurisë apartament banimi, ka provuar dhe shpjeguar tej çdo dyshimi të arsyeshëm ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Subjekti ngre pretendimin se diferenca e konstatuar si balancë negative për blerjen e kësaj pasurie nuk është analizuar në vendimin e Komisionit. Sipas subjektit të rivlerësimit, diferenca negative në shumën 10.191.152 lekë rezulton pasi nuk janë konsideruar të ardhurat nga bujqësia. Gjithashtu, subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit që i referohet kontradiktave në deklaram për burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi ky burim është i njëjtë si në deklaratën *vetting*, ashtu edhe në DIPP-në e vitit 2010, pavarësisht se është shprehur me fjalë të ndryshme. Subjekti pretendon se huaja prej 5.000 eurosh, marrë mikut të tij, z. Xh. Xh., nuk është deklaruar në deklaratën *vetting* dhe as në DIPP-në e vitit 2010, e cila ka ardhur për shkak të një gabimi njerëzor apo pasaktësi e paqëllimshme, e cila nuk cenon ligjshmërinë e të ardhurave. Në kushtet kur ky detyrim është shlyer brenda vitit, subjekti pretendon se nuk ka pasur detyrimin ta deklarojë atë. Gjithashtu, për shumën 170.000 lekë, e cila është marrë hua nga djali i subjektit të rivlerësimit tek z. E. T., subjekti sqaron se kjo hua është shlyer brenda vitit të deklaramit dhe, për këtë arsye, nuk është deklaruar në deklaratën përkatëse. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni gabimisht ka përfshirë në analizën financiare të vitit 2010 transaksionin prej 30.000 eurosh në Bankën Kombëtare Tregtare, transaksion i cili nuk i përket subjektit, pasi nuk është ai personi që ka depozituar këtë shumë për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji të konsiderojë të pavërtetë konkluzionin e Komisionit se zhvendosja nga subjekti i rivlerësimit i datave të deklaramit të pagesave të apartamentit ka ardhur me qëllim justifikimin e krijimit të pasurisë me burime të tjera përveç atyre të deklaruara në DIPP-në e vitit 2010. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendoi se lidhur me pagesën e 30.000 eurove nuk i është njoftuar në rezultatet e hetimit të Komisionit barrë prove për deklaram të rremë, për të cilin Komisioni ka konkluduar vetëm në vendimin përfundimtar.

19.1 Arsyetimi dhe konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë pasuri: *“Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pagesat e kryera për blerjen e këtij apartamenti dhe ka shtrembëruar faktet me qëllimin e vetëm që të justifikonte burimin e krijimit të tyre, duke qenë se rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të kryer pagesën prej 80.000 eurosh, në datën 08.02.2010. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, ka bërë deklaram të rremë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e këtyre të ardhurave, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germat “a” “b” dhe “ç”, të ligjit nr. 84/2016”.*

19.2 Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shtëpi banimi (apartament) e ndodhur në rrugën “{***}”, me sipërfaqe funksionale 97,7m² dhe me gjithë sipërfaqet e përbashkëta 106,44 m². Prona ndodhet në katin e tretë të godinës 9-katëshe, në rrugën “{***}”, shkalla nr. {***} (pallati {***}). Regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 08.01.2016, me nr. {***} pasurie, zona kadastrale {***}. Blerë me të ardhurat e siguruara gjatë viteve 1994-2010, nga puna dhe ferma bujqësore e bletaria në vlerën 85.000 (11.756.500 lekë) dhe 3.300 euro me të ardhurat e vitit 2014”.

Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: “Prenotuar shtëpi banimi (apartament) ndodhur në rrugën “{***}”, me sipërfaqe 106,44 m², sipas kontratës së sipërmarrjes lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.02.2010, të noteres M. Sh. [...] 88.300 euro, likuiduar deri më 31.12.2010 85.000 euro [...]. Pakësuar gjendja likuiditeteve cash grumbulluar gjatë viteve deri më 31.12.2010. Shuma është përdorur për të bërë pagesën e banesës së prenotuar (85.000 x 138,311=11.756.500 lekë këmbyer në datën 05.02.2010”.

Në rubrikën detyrime, subjekti i rivlerësimit deklaron: “Mbetur pa shlyer kësti i fundit prej 3.300 eurosh shoqërisë “{***}” ShPK, për vlerën e banesës shtëpi banimi (apartament), e ndodhur në rrugën “{***}” (Bulv. “Zhan D’Ark”), me sipërfaqe 106,44 m², sipas kontratës së sipërmarrjes së lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.02.2010, të noteres M. Sh., këst i cili do të paguhet në momentin e kalimit të pronësisë”.

Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti deklaron: “[...] 400.000 shlyer detyrim për prenotimin e banesës së deklaruar më parë, detyrimi i prapambetur (2.850 euro x 140 lekë/euro) ndaj shoqërisë “{***}” ShPK”.

Në rubrikën e detyrimeve financiare të kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit shkruan: “Shlyer detyrimi prej 3.300 eurosh shoqërisë “{***}” ShPK, nga e cila 400.000 lekë shlyer nga kursimet në vite (2.840 euro x 140 lekë/euro) dhe 64.400 lekë nga kursimet e vitit 2014 (460 euro x 140 lekë/euro)”.

19.3 Sipas dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka porositur te shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK një apartament banimi me sip. 106,44 m², nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.02.2010. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate, me titull “çmimi dhe mënyra e pagesës”, është parashikuar se palët bien dakord që çmimi i ambientit të shërbimit objekt kontrate të jetë 88.300 euro. Porositësi do të paguajë: vlerën 50.000 euro, me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes; vlerën 20.000 euro, brenda datës 31.03.2010; dhe vlerën 18.300 euro, në datën 31.05.2010, me marrjen e çelësave të apartamentit. Më datë 28.12.2015, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., sipas të cilës është parashikuar se apartamenti është shitur kundrejt shumës 88.300 euro, likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 08.02.2010. Në DIPP-në e vitit 2010 në rubrikën për detyrimet financiare ndaj personave juridikë, subjekti ka deklaruar si të mbetur pa shlyer shumën prej 3.300 eurosh, këst i cili do të paguhej në momentin e kalimit të pronësisë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 se shumën prej 85.000 eurosh e ka likuiduar deri më 31.12.2010.

19.4 I pyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit të datës 19.11.2019, lidhur me pagesat e kryera, si dhe duke i kërkuar depozitimin e mandatarkëtimit që ka kryer këto pagesa, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “Kësti i parë prej 50.000 eurosh është paguar në datën e lidhjes së kontratës, datë 08.02.2010. Në datën 22.03.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 7.000

euro, vërtetuar me mandatpagesën e kësaj date [...]. Në datën 30.03.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 10.000 euro vërtetuar me mandatpagesën e kësaj date [...].

Në datën 05.04.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 3.000 euro vërtetuar me mandatpagesën e kësaj date [...]. Në datën 17.05.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 5.000 euro, vërtetuar kjo me mandatpagesën e kësaj date. Ky këst është shlyer nga një hua që i kam marrë mikut tim (dhe kumbarit të nipit) Xh. Xh. në datën 17.05.2010 dhe që ia kam kthyer në datën 16.11.2010 (shlyerja e huas është bërë nga të ardhurat e vitit 2010). Në datën 28.05.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 4.000 euro, vërtetuar kjo me mandatpagesën e kësaj date. Ky këst është shlyer nga shitja e bletëve në prill të vitit 2010 (450.000 lekë) dhe diferenca nga kursimet ndër vite. Në datën 02.07.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 3.000 euro vërtetuar me mandatpagesën e kësaj date [...]. Në datën 09.07.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 3.000 euro vërtetuar me mandatpagesën e kësaj date [...]. Kësti i fundit në shumën 3.300 euro është paguar në datën 28.12.2014”.

19.5 Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë burimet e krijimit që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti në deklaratën *vetting*, për shkak se: (i) në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi se si burim për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer të ardhurat e siguruar gjatë viteve 1994 – 2010 nga puna, ferma bujqësore dhe bletaria në vlerën 85.000 euro; (ii) ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti deklaroi se ka pakësuar gjendjen e likuiditeteve *cash* e grumbulluar gjatë viteve, deri më 31.12.2010, për të bërë pagesën e banesës së prenotuar; (iii) ndërkohë që gjatë hetimit administrativ ka ndryshuar deklarim në lidhje me burimin, pra, ka shtuar një burim të ri, duke shpjeguar se pagesat për këtë apartament nuk janë kryer sipas kontratës së sipërmarrjes, ku, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] në datën 17.05.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 5.000 euro, vërtetuar kjo me mandatpagesën e kësaj date. Ky këst është shlyer nga një hua që subjekti i rivlerësimit i ka marrë mikut të tij (dhe kumbarit të nipit) Xh. Xh. në datën 17.05.2010 dhe që ia ka kthyer në datën 16.11.2010 (shlyerja e huas është bërë nga të ardhurat e vitit 2010) [...]. Këtë konkluzion të Komisionit e kundërshtoi subjekti i rivlerësimit, i cili pretendon se është i njëjti burim, por i shprehur në mënyra të ndryshme. Lidhur me mosdeklarimin e huas prej 5.000 eurosh të marrë nga miku i tij, subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo pasaktësi, duke qenë se vërtetohet aftësia paguese e tij, nuk mund të shërbejë si shkak i marrjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

19.6 Gjatë hetimit administrativ rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as në deklaratën *vetting* dhe as në DIPP-në e vitit 2010 huan në shumën 5.000 euro, ndaj mikut të tij z. Xh. Xh., të marrë në datën 17.05.2010 dhe kthimin në datën 16.11.2010. Subjekti shpjegoi në Komision se nuk e ka deklaruar këtë hua duke qenë se ajo është shlyer brenda vitit dhe nuk e ka pasur gjendje si detyrim në fund të vitit për të cilin deklaroi. Bazuar në ligjin nr. 9049/2003, në nenin 4, germa “a”, parashikohet se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI burimin e krijimit për pasuritë e paluajtshme. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte të plotë dhe të qartë burimin e krijimit të pasurisë së apartamentit banimi. Për më tepër rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar as në deklaratën *vetting* huan si burim i krijimit të kësaj pasurie në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Pavarësisht se subjekti pretendon se kjo hua është shlyer brenda vitit 2010, trupi gjykues vlerëson se subjekti kishte detyrimin ta deklaronte, pasi ajo ka

shërbyer si një burim për krijimin e pasurisë, si rrjedhojë Kolegji vlerësoi se Komisioni me të drejtë ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

19.7 Lidhur me arkëtimin në Bankën Kombëtare Tregtare të shumës prej 30.000 eurosh, për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, ILDKPKI-ja ka administruar shkresën nr. {***} prot., datë 10.05.2017, nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (në vijim “DPPPP”), sipas së cilës ka raportime për transaksione bankare, ku më datë 08.02.2010 subjekti i rivlerësimit ka paguar 30.000 euro, si këst për blerje apartamenti. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit të datës 19.11.2019, se në datën 08.02.2010, të njëjtën datë me transaksionin e mësipërm, ka paguar *cash* pranë arkës së shoqërisë këstin e parë prej 50.000 eurosh, dhe se nuk ka kryer asnjë pagesë me bankë prej 30.000 eurosh, siç rezulton nga shkresa e DPPPP-së. Komisioni i kërkoi BKT-së informacion mbi këtë transaksion bankar, e cila informoi¹⁸ se nga sistemi kompjuterik i bankës rezultoi një pagesë e kryer në datën 08.02.2010, në vlerën 30.000 euro, veprim i kryer nga subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko, i datëlindjes 05.02.1959 dhe me përfitues subjektin “{***}” ShPK, duke dhënë dhe detajet bankare të këtij subjekti tregtar. Bashkëngjitur shkresës, BKT-ja ka dërguar mandatarkëtimin, tek i cili është shënuar se burimi i të ardhurave janë kursime të ndryshme, si dhe bashkëlidhur këtij mandati gjendet edhe kopja e pasaportës së subjektit të rivlerësimit. Komisioni i kërkoi informacion edhe shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK lidhur me këtë situatë, e cila ka informuar¹⁹ se të gjitha pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko, në lidhje me blerjen e pasurisë “apartament banimi”, janë kryer nëpërmjet pagesës *cash* sipas mandatarkëtimeve, kopjet e të cilave janë dorëzuar edhe pranë zyrës noteriale ku është përpiluar kontrata e shitblerjes.

19.8 Lidhur me informacionin e BKT-së, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit, i cili në përgjigjet e datës 05.03.2020 ka shpjeguar se: *“Në lidhje me këtë informacion të bërë nga BKT-ja ju bëj me dije se nga ana ime nuk është bërë asnjë transaksion bankar për llogari të BKT-së. Sikurse ju kam sqaruar hollësisht të gjitha pagesat janë kryer në arkën e shoqërisë “{***}” ShPK, në zyrat e saj dhe për çdo pagesë jam pajisur me mandatarkëtimin përkatës. Të gjitha kopjet i janë bashkëngjitur kontratës së shitjes së apartamentit. [...] Transaksionin në fjalë nuk kisha asnjë arsye të mos e deklaroja, pasi kjo mënyrë do të ishte dhe mënyrë me e saktë për të shmangur çdo spekulim, ndërkohë kam qenë i detyruar që pagesën e këstit ta bëja në arkën e shoqërisë, pasi në këtë mënyrë vepronte përfaqësuesi i shoqërisë. [...] Është e vërtetë se transaksionit i është bashkëngjitur edhe kopje e pasaportës, të cilës i kanë bërë edhe shënime në lidhje me ermin e babait, numrin e telefonit dhe vendbanimin, shënime të cilat nuk janë bërë nga unë. Është lehtësisht i verifikueshëm shkrimi dhe nënshkrimi, për më tepër, që në rast se do të isha paraqitur unë në bankë nuk kishte pse në fotokopjen e pasaportës të shënoja emrin e babait, numrin e telefonit dhe vendbanimin, kur në prezencë do ua kisha thënë vetë. Besoj se kështu duhet të jetë, që kjo pagesë është bërë nga vetë shoqëria, pasi edhe shkrimet dhe nënshkrimet nuk më përkasin mua”*.

19.9 Në analizën financiare të kryer në Komision, shuma prej 30.000 eurosh, e rezultuar nga informacionet e DPPPP-së dhe BKT-së, është përfshirë në analizën financiare të vitit 2010 si

¹⁸ Me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2020.

¹⁹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 24.02.2020.

shpenzim i subjektit të rivlerësimit, duke e konsideruar si pagesë të kryer prej tij për blerjen e apartamentit.

19.10 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 30.04.2020, kallëzim penal ndaj shoqërisë “{***}” ShPK dhe Bankës Kombëtare Tregtare, sepse pretendon që me veprimet e tyre të paligjshme i kanë shkaktuar një dëm të madh duke falsifikuar nënshkrimin e tij dhe duke pasqyruar të dhëna të pavërteta. Subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision aktin e ekspertimit grafik nr. {***}, datë 21.04.2020, nga i cili i ka kërkuar ekspertit kriminalist të bëjë verifikimet e nënshkrimeve të tij tek: (1) “Formular mandatarkëtimi” plotësuar me shkrim dore, datë 08.02.2010, në BKT; dhe (2) dokument i printuar nga sistemi i bankës, në të cilin përshkruhet transaksioni bankar dhe mban emër, mbiemër dhe nënshkrimin me shkrim dore (në këtë dokument është shkruar emri Hysem Saliko). Eksperti kriminalist V. H., në aktin e ekspertimit të datës 21.04.2020, ka konkluduar se: *“1. Dy nënshkrimet në emër të shtetasit Hysen Saliko, të formës emër-mbiemër-firmë, në të dy dokumentet objekt ekspertimi [...] nuk janë shkruar dhe firmosur nga Hysen Saliko. Dy firmat në fjalë, në emër të shtetasit Hysen Saliko, në dy dokumentet objekt ekspertimi janë pa asnjë dyshim produkte të imitimeve dhe sajimeve grafike. 2. Të gjitha plotësimet me shkrim dore në dokumentin e parë objekt ekspertimi [...] janë shkruar nga personi që ka plotësuar dy mandatarkëtimet me vulat e shoqërisë “{***}” ShPK e, pikërisht ato me numër serie {***} dhe nr. mandati {***}, për shumën 7.000 euro dhe mandati me nr. serie {***} dhe nr. {***}, për shumën 10.000 euro, të cilat ishin në këtë ekzaminim me cilësinë e modeleve të krahasimit”*. Lidhur me këtë akt ekspertimi, Komisioni ka vlerësuar se është një provë që i shërben procesit penal dhe jo atij administrativ.

19.11 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, lidhur me kallëzimin e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 08.05.2020 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2020, me arsyetimin se procesi penal për këtë fakt nuk mund të fillojë për shkakun se ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe duke pasur parasysh që dokumenti që pretendohet të jetë i falsifikuar është i datës 08.02.2010, afatet e parashkrimit kanë kaluar. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi këtë vendim të Prokurorisë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. {***}, datë 08.06.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe prishjen e vendimit, datë 08.05.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {***}, datë 30.04.2020” dhe urdhërimin për regjistrimin e hetimit penal në drejtim të veprës penale “falsifikimi i dokumenteve” të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka kërkuar prishjen e tij dhe rrëzimin e kërkesës, ndërsa subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko ka paraqitur apel kundërshtues, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit.

Gjykata e Apelit Tiranë vendosi mospranimin e ankimit të prokurorisë ndaj vendimit nr. {***}, datë 08.06.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak se prokuroria ka hequr dorë nga ankimi.

19.12 Nga vendimmarrja e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila urdhëroi vazhdimin e hetimeve të kësaj çështjeje, duket qartë që është konstatuar se prokuroria nuk ka kryer veprime të thella hetimore. Në këtë vendim është arsyetuar se prokurori ka ardhur në dijeni të faktit që këto dokumente janë të falsifikuara, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor dhe, për më tepër, nuk ka verifikuar kur është përdorur për herë të fundit ky dokument i falsifikuar, si dhe nga kush është përdorur. Gjykata, më tej, arsyeton se nëse Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë do të kishte kryer veprime hetimore do të arrinte në konkluzion e saktë se të paktën për punonjësit e BKT-së nuk është parashkruar ndjekja penale, pasi ata kanë përdorur në datën 04.03.2020 një dokument që është i falsifikuar, dokument i cili për ankuesin sjell pasoja të rënda. Prokurori duhet të kryente një hetim të plotë e të gjithanshëm në drejtim të veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal apo të konsumimit të elementëve të ndonjë vepre tjetër penale.

Nga kjo vendimmarrje e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, del qartazi që prokuroria nuk ka kryer hetime të thelluara, ndaj është urdhëruar për të kryer hetim të plotë dhe të gjithanshëm, të kryejë akt ekspertimin grafik dhe t’i marrë kallëzuesit shpjegime rreth kallëzimit. Në këto rrethana, rezultoi se prokurori në Gjykatën e Apelit Tiranë është tërhequr nga ankimi dhe ka mbetur në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve, për të cilat gjykata vërejti se nuk janë kryer, ndaj për këtë fakt urdhëroi vazhdimin e tyre.

19.13 Subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision një deklaratë noteriale, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.03.2020, në të cilën deklaruesi shoqëria “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. Sh. K., deklaroi se ka lidhur kontratën e sipërmarrjes, datë 08.02.2010, me subjektin e rivlerësimit Hysen Saliko në lidhje me një apartament të përcaktuar në këtë kontratë. Sipas deklaruesit, subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko ka shlyer të gjitha pagesat në masën 88.300 euro të përcaktuara në kontratën përfundimtare të shitjes, bashkëlidhur të cilës i janë edhe mandatet përkatëse që dokumentojnë kryerjen e pagesës së apartamentit. Sipas deklaruesit, nga subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko është shlyer shuma prej 50.000 eurosh në arkën e shoqërisë, sipas mandatarkëtimit me nr. {***}, datë 08.02.2010. Sipas tij prej kësaj shume të depozituar në arkë nga subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko nga ana e kompanisë është kryer transaksioni bankar në datën 08.02.2010, pranë BKT-së, në shumën 30.000 euro, prej punonjësve të shoqërisë së ndërtimit, në emër të subjektit të rivlerësimit Hysen Saliko.

Në dosjen e administruar prej Komisionit gjendet edhe vërtetimi i datës 06.03.2020 i lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, me administrator Sh. K., në të cilin sqarohet se veprimin bankar në shumën prej 30.000 eurosh në BKT nuk e ka kryer subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko, por është arkëtuar nga shoqëria. Në këtë vërtetim shpjegohet se për shkak të periudhës së gjatë kohore dhe mosadministrimit të dokumentacionit të plotë, nuk janë në gjendje të përcaktojnë se kush nga punonjësit e kompanisë e ka kryer transaksionin e BKT-së.

19.14 Lidhur me informacionin e DPPPP-së e, më pas, të BKT-së, për pagesën prej 30.000 eurosh si të paguar nga subjekti i rivlerësimit nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se në aktin e ekspertimit grafik të porositur dhe dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit është konkluduar nga eksperti se emri dhe nënshkrimi i vendosur në dy dokumentet objekt ekspertimi nuk i përkasin subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, edhe në vendimin e Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Tiranë të sipërcituar, është urdhëruar prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vazhdimin e hetimeve të thelluara dhe të gjithanshme lidhur me veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve” apo të ndonjë vepre tjetër penale, pasi kjo gjykatë konstatoi disa elementë për të cilët ishte i nevojshëm vazhdimi i hetimeve, si dhe konstatoi se nuk janë kryer hetime nga prokuroria për të arritur në vendimmarrjen e mosfillimit të procedimit penal. Bazuar në provat e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se ato ishin të mjaftueshme për të mos konsideruar si të paguar nga subjekti i rivlerësimit pagesën prej 30.000 eurosh, nëpërmjet BKT-së në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, pa qenë nevoja e marrjes së provave të reja të paraqitura në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi të mos konsiderojë shumën prej 30.000 eurosh si të paguar nga subjekti i rivlerësimit, duke mos e përfshirë atë në analizën financiare për vitin 2010.

19.15 Nga kontrolli që Kolegji, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, i bëri analizës financiare të kryer nga Komisioni, lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë apartament me sip. 106.44 m², në Tiranë, rezultoi se Komisioni nuk ka njohur si burim të blerjes së kësaj pasurie të ardhurat e pretenduara nga subjekti nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria për periudhën 1993-2010. Për periudhën 1993-2002, Komisionit ka konkluduar një diferencë negative në shumën 676.964 lekë. Në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, për të njëjtën periudhë rezultoi me diferencë negative në shumën (-) 176.964 lekë, diferencë e ndryshme nga Komisioni, pasi në analizën e këtij të fundit gjendja e likuiditeteve *cash* në banesë në shumën 2.000.000 lekë është konsideruar si gjendje e kursimit deri në vitin 2002, ndërkohë që ky kursim është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në fund të vitit 2003. Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2002 ka qenë në vlerën 1.500.000 lekë dhe gjatë vitit 2003 gjendja e likuiditeteve *cash* është shtuar në vlerën 500.000 lekë, për këtë arsye, Kolegji vlerësoi që kjo shumë të mos i konsiderohet në analizën financiare të periudhës 1993-2002, për shkak se gjendja *cash* prej 500.000 lekësh është kursim i krijuar gjatë vitit 2003 dhe duhet të konsiderohet si pjesë e kursimeve që subjekti i rivlerësimit ka përdorur për blerjen e apartamentit të banimit në rrugën “{***}”, Tiranë, në vitin 2010.

19.16 Nga kontrolli që Kolegji i bëri analizës financiare të Komisionit, rezultoi se për periudhën 2003-2010 subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme për të përballuar shpenzimet, pasuritë dhe kursimet në vitin 2005, për shumën 969.069 lekë. Për vitin 2006 subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve me diferencë negative në shumën (-) 264.759 lekë. Kjo diferencë është më e ulët se ajo e rezultuar në Komision [(-) 492.567 lekë], për arsye se nga kontrolli i ushtruar në Kolegj është konsideruar edhe depozita bankare e nënës së subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” e maturuar në datën 01.05.2006, në shumën 205.513 lekë, depozitë të cilën Komisioni nuk e ka përfshirë në analizën financiare. Gjithashtu, Komisioni i ka përlllogaritur shpenzime udhëtimi subjektit të rivlerësimit për vitin 2006, për një aktivitet të organizuar nga KLD-ja dhe Ministria e Drejtësisë, ku shpenzimet janë mbuluar nga organizatorët. Nga kontrolli që Kolegji i bëri analizës financiare të Komisionit për vitin 2007, rezultoi se diferenca negative në shumën (-) 1.711.425 lekë gjendet e drejtë. Për vitin 2008, rezultoi se subjekti i rivlerësimit gjendet me diferencë negative në shumën (-) 573.418 lekë, e cila rezulton më e ulët se e Komisionit [(-) 628.850 lekë], për arsye se Kolegji vlerësoi se duhet të mos përfshihen në analizën financiare të vitit 2008 shpenzimet për udhëtimin lidhur me një vizitë studimore të

subjektit të rivlerësimit në Spanjë e organizuar dhe financuar nga Bashkimi Evropian. Për vitin 2009 subjekti i rivlerësimit rezultoi me diferencë negative në shumën 659.939 lekë, e cila rezulton më e ulët se e Komisionit [(-) 730.491 lekë], për arsye se Kolegji vlerësoi të mos përfshihen në analizën e këtij viti shpenzimet e udhëtimit në Portugali të organizuar nga Këshilli i Lartë i Magjistraturës, shpenzimet e të cilit janë mbuluar nga organizatorët. Për vitin 2010 subjekti i rivlerësimit rezultoi me diferencë negative në shumën 817.487 lekë, e cila rezulton më e ulët se e Komisionit [(-) 4.981.787 lekë], duke mos konsideruar si të kryer nga subjekti pagesën prej 30.000 eurosh në favor të shoqërisë “{***}” ShPK.

19.17 Në përfundim të analizimit të shkakut të ankimit, lidhur me pasurinë “apartament banimi me sip. 106.44 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me mënyrën e deklaramit të pagesës së apartamentit në vitin 2010, pasaktësi kjo e cila rezulton e shoqëruar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë në shumën 5.171.732 lekë (në ndryshim nga Komisioni, i cili e ka vlerësuar mungesën e burimeve të ligjshme në shumën 10.191.152 lekë), për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të ardhurat e deklaruara dhe pretenduara të krijuara nga bujqësia, blegtoaria e pemëtaria. Për këtë pasuri, Kolegji vlerësoi të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të përbulluar shpenzimet, pasuritë dhe kursimet në kuptim të nenit 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

- 20. Lidhur me dy garazhet e ndodhur në katin e dytë nëntokë të godinës 9-katëshe**, me sipërfaqe 15,8 m² secili, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit, për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive në shumën 872.420 lekë, është i gabuar. Sipas subjektit, Komisioni edhe për vitin 2015, në mënyrë të padrejtë nuk i ka konsideruar të ardhurat nga bletaria dhe pemëtaria. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka gabuar edhe në përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin 2015, duke qenë se ai ka qenë i ndarë nga djali i tij I. S.. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka gabuar edhe në përllogaritjen e shpenzimeve për udhëtim në vitin 2015, duke qenë se ai ka deklaruar shpenzime për pushime në shumën 400.000 lekë, të cilat sipas subjektit janë përllogaritur dy herë.

Subjekti i rivlerësimit pretendon se deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe se ka burime të ligjshme financiare për krijimin e këtyre pasurive.

20.1 Konkluzioni i Komisionit lidhur me këto pasuri: “Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për vitin 2015, për të blerë pasuritë dhe për të kryer shpenzimet, me një balancë negative prej (-) 872.420 lekësh, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016”.

20.2 Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Dy garazhe në emër të Hysen dhe F. Saliko, me sipërfaqe 15,8 m² secili (gjithsej 31.6 m²), regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me nr. {***} dhe nr. {***} regjistri hipotekor, datë 08.01.2016, me nr. {***} dhe nr. {***} pasurie, të ndodhura në katin e dytë nëntokë të godinës 9-katëshe, në rrugën “{***}”. Blerë me të ardhurat nga kursimet e vitit 2015”.

Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Blerë dy garazhe në emër të Hysen dhe F. Saliko, me sipërfaqe 15,8 m² secili (gjithsej 31.6 m²), me kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.12.2015, të noteres M. Sh.. Shlyer në rrugë bankare me të ardhurat nga kursimet e vitit 2015”.*

20.3 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, rezultoi se ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit të rivlerësimit dhe djalit të tij në cilësinë e blerësve është nënshkruar kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.12.2015, për blerjen e dy garazheve dhe apartamentit 106.44 m². Në kontratë parashikohet se shuma prej 6.000 eurosh për blerjen e garazheve do të kalojë nëpërmjet numrit të llogarisë së noterit në bankë dhe më pas në numrin e llogarisë së shoqërisë. Bashkëlidhur kontratës së shitjes gjendet një dokument i Raiffeisen Bank me përshkrimin *depozitim për të tretë*, ku në datën 28.12.2015, z. F. S. ka derdhur shumën prej 6.000 eurosh, në favor të noteres M. Sh., me përshkrim të veprimt *kalim sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.12.2015*.

Nga analiza financiare për vitin 2015, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e dy garazheve në shumën 872.420 lekë dhe për këtë i kaloi subjektit barrën e provës dhe e ftoi të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e dy garazheve.

20.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me barrën e provës, shpjegoi se: *“Ky konkluzion është i gabuar, pasi në analizën financiare nuk gjejmë pasqyrim disa veprime, konkretisht nuk janë përfshirë në tabelë të ardhura nga ferma bujqësore, bletaria dhe pemëtaria në shumën 1.000.000 lekë. [...] Sipas analizës financiare të korrektuar rezultoi se në fund të vitit 2015 bilanci financiar është në shumën 346.886 lekë”.*

20.5 Në përfundim të këtij shkaku ankimi, nga kontrolli që Kolegji i bëri analizës financiare të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të krijojë pasuritë garazhe dhe të përballojë shpenzimet e jetesës për vitin 2015, për diferencën negative në shumën (-) 783.875 lekë, e cila rezultoi më e ulët me 88.545 lekë në krahasim me Komisionin për shkak të rilogaritjes së disa shpenzimeve udhëtimi, sipas metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji në jurisprudencën²⁰ e tij. Si rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit, se subjekti për blerjen e garazheve ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, gjendet i bazuar.

21. Lidhur me automjetin tip “Volkswagen Bora”, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në shumën 628.850 lekë është i gabuar. Sipas subjektit, Komisioni edhe për vitin 2008 në mënyrë të padrejtë nuk i ka konsideruar të ardhurat nga bujqësia dhe bletaria. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji të korrigjojë analizën financiare të kryer nga Komisioni duke përfshirë në të ardhurat e ligjshme, ato të krijuara nga bujqësia, pemëtaria dhe bletaria.

21.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *“Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për vitin 2008 për të blerë pasuritë*

²⁰ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019.

dhe për të kryer shpenzimet, me një balancë negative prej (-) 628.850 lekësh, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016”.

21.2 Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Autoveturë, marka Volkswagen, tip Bora, viti i prodhimit 2002, blerë në datën 25.08.2008, me të ardhurat e siguruara gjatë vitit 2008 [...] vlera 500.000 lekë”.

Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “Autoveturë tip Volkswagen Bora, blerë me të ardhurat e siguruara gjatë vitit 2008, nga pagat dhe të ardhura të tjera [...] vlera 500.000 lekë”.

21.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se DPSHTRr-ja ka informuar Komisionin se pranë këtij institucioni gjendet kontrata e shitblerjes së automjetit me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.2008, sipas të cilës subjekti blen automjetin e përshkruar më sipër në çmimin 500.000 lekë. Bashkëlidhur kontratës rezulton një prokurë e posaçme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.07.2008, sipas të cilës B. M. (pronarja e mjetit) autorizon individët Hysen dhe I. Saliko.: (i) që ta përfaqësojnë që të dy bashkërisht apo veçmas për të nënshkruar në emër dhe llogari të saj kontratën e shitblerjes, me një çmim që ta gjykojnë të arsyeshëm përfaqësuesit; (ii) për të bërë zhdoganimin e automjetit; dhe (iii) për ta përdorur sipas ligjit. Përfaqësuesi deklaroi se e ka marrë në dorëzim automjetin në fjalë, përfundimisht pa të drejtë kthimi dhe se për çfarëdolloj problemi ligjor që mund të dalë mban personalisht përgjegjësi ligjore. Znj. B. M. deklaroi se i jep tagër të plotë veprimi përfaqësuesit dhe veprimet e tij i konsideron të mirëqena njëlloj sikur t’i kishte kryer personalisht i përfaqësuar. Gjithashtu, në dosjen e mjetit gjendet dokumenti deklaratë doganore e datës 23.08.2008, sipas të cilës, për zhdoganimin e mjetit është paguar shuma prej 197.506 lekësh. Nga aktet e administruara në dosje, të depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk rezultoi e qartë nëse kjo shumë i shtohet çmimit të blerjes së automjetit prej 500.000 lekësh apo është përfshirë brenda kësaj shume. Subjekti u pyet nga Komisioni për mënyrën e kryerjes së pagesës dhe për çmimin e shitblerjes së automjetit, nëse përfshihej edhe pagesa doganore. Në përgjigjet e datës 30.04.2020 të pyetësorit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se për blerjen e automjetit në vitin 2008 pagesa është bërë *cash*, në shumën prej 500.000 lekësh, ku përfshihen edhe detyrimet doganore.

21.4 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe djali i tij, sipas prokurës së posaçme të nënshkruar më datë 28.07.2008, kanë pasur tagra për të nënshkruar kontratën e shitjes së automjetit, si dhe për të kryer zhdoganimin e tij, i cili sipas deklaratës doganore është kryer më datë 23.08.2008. Kontrata e shitjes së automjetit, referuar paragrafit më sipër është nënshkruar më datë 28.08.2008, pra, një kohë të afërt me datën e zhdoganimit të mjetit, çka krijon bindjen se të gjithë këto veprime të kryera në një periudhë kohore të afërt janë kryer në funksion të blerjes së automjetit dhe janë përballuar me shpenzimet e subjektit të rivlerësimit. Si rrjedhojë, Kolegji e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit për ta përfshirë pagesën doganore në çmimin e blerjes së automjetit. Në përfundim të këtij shkaku ankimi, nga kontrolli që Kolegji i bëri analizës financiare të Komisionit, rezultoi se për vitin 2008 subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për diferencën negative në shumën (-) 573.418 lekë, e cila rezultoi më e ulët me

55.432 lekë në krahasim me Komisionin, për shkak të rilogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit jashtë Shqipërisë. Si rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit, se subjekti për blerjen e këtij automjeti ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, gjendet i bazuar.

22. **Në lidhje me llogarinë rrjedhëse të krijuar në “Credins Bank”,** në vitin 2016, në emër të L. dhe M. S. (bashkëshortja dhe nëna e subjektit), subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit në lidhje me këtë shkak ankimi është në shkelje të pikës 1, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, në shkelje të nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në shkelje të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Sipas subjektit të rivlerësimit qëndrimi i Komisionit është i pabazuar dhe i pavërtetë në kundërshtim me provat e paraqitura prej subjektit, të cilat, sipas tij, janë konsideruar të mirëqena nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit pretendon se faturat tatimore janë akte me fuqi të plotë provuese dhe janë tituj ekzekutivë për sa i përket rimbursimit të TVSh-së, ndaj vlefshmëria e tyre nuk vihet në dyshim.

22.1 Arsyetimi dhe konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: “[...] Nëna si përfaqësuese e familjes bujqësore nuk ka të drejta mbi dhurimin e të ardhurave nga frytet e kësaj prone vetëm për subjektin, por të gjithë anëtarët e familjes bujqësore duhet të shprehen mbi dhurimin e këtyre të ardhurave për subjektin, duke qenë se janë të ardhura të përfituara nga toka në bashkëpronësi, për më tepër që subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues që investimet/shpenzimet për pemëtari dhe bletari ishin kryer prej tij. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar të ardhurat nga bletaria dhe pemëtaria, të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj depozite dyemërore edhe pse këto të ardhura sipas faturave tatimore janë përfitur vetëm nga nëna e subjektit të rivlerësimit, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016”.

22.2 Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Llogari rrjedhëse depozituar në Credins Bank në depozitën, me numër {***}, në emër të L. dhe M. S., nga të ardhurat e siguruar nga pemëtaria, toka dhe bletaria gjatë vitit 2016 [...] vlera 1.575.136 lekë”.

Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “Llogari rrjedhëse depozituar në “Credins Bank” në depozitën, me numër {***}, në emër të L. dhe M. S., nga të ardhurat e siguruar nga pemëtaria, toka dhe bletaria gjatë vitit 2016 (administruar prej nënës) vlera 1.575.136 lekë”.

22.3 “Credins Bank”, nëpërmjet shkresës me nr. {***} prot., datë 28.02.2019, ka konfirmuar se L. dhe M. S. kanë pasur depozitë dyemërore me gjendje në shumën 1.575.382 lekë, në vitin 2016. Nga pasqyra e llogarisë pranë kësaj banke rezulton se depozita ka pasur balancë kreditore në tetor të vitit 2016 dhe është kaluar në depozitë pa afat. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 ka rezultuar në shumën 1.575.382,3 lekë. Gjatë vitit 2017 dhe 2018 kjo llogari është kredituar nga “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, me përshkrimin likuidim faturash të ndryshme. Tepëricat kreditore të kësaj llogarie kaloheshin në depozitë, balanca e të cilës deri në datën 31.12.2018 ka qenë në vlerën 3.517.365 lekë.

22.4 Nga hetimi i kryer dhe dokumentacioni i administruar në dosje, Komisioni ka arsyetuar në vendim se subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentacion ligjor shitjen e produkteve në

shumën 1.582.440 lekë për vitin 2016, por nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar që këto të ardhura i përkisnin vetëm familjes së tij. Lidhur me këtë konstatim, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Nga certifikata familjare rezulton se nëna është kryefamiljare, pra, në referim edhe të nenit 224 të Kodit Civil, është kryetare e familjes bujqësore dhe, si e tillë, si në të gjitha DIPP-të, ashtu edhe në deklaratën vetting është përfshirë në familjen e subjektit. Për rrjedhojë, si të ardhurat, ashtu edhe shpenzimet janë llogaritur së bashku. Në bazë të nenit 222 të Kodit Civil, pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore u përket në tërësi anëtarëve të saj. Kjo ka qenë edhe arsyeja që pajisja me NIPT është bërë nga nëna në cilësinë e kryefamiljares. [...] Por pavarësisht këtyre parashikimeve dhe prezumimeve ligjore, nëna nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.06.2020, ka deklaruar se të gjitha të ardhurat që janë siguruar nga ferma bujqësore kanë kaluar në llogari të djalit. Në këtë deklaratë ajo pranon faktin se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këto të ardhura. Gjithsesi, shuma prej 1.574.440 lekë ndodhet ende në depozitë bankare në emër të saj dhe bashkëshortes L. S.”.*

22.5 Kolegji vëren se lidhur me faktet dhe rrethanat e renditura më sipër rezultoi e provuar se kjo depozitë është krijuar nga të ardhurat e vitit 2016 nga bujqësia e bletaria, të ardhura të cilat janë provuar nga subjekti i rivlerësimit me fatura TVSh-je, pasi nëna e subjektit figuron e regjistruar në organet tatimore dhe është pajisur me NIPT. Gjithashtu, rezultoi e provuar edhe nga dokumentacioni i sjellë nga “Credins Bank” se kjo depozitë është në emër të nënës dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Nëna e subjektit është person i lidhur i subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, pasi është person i përfshirë në certifikatën familjare të subjektit të rivlerësimit. Fakti që motrat e subjektit të rivlerësimit janë formalisht bashkëpronare, nuk do të thotë që detyrimisht kanë investuar dhe duhet të marrin të ardhura nga bujqësia, pasi kjo është situatë faktike e lidhur me vullnetin e tyre për të përfutur frytet e këtyre tokave, si dhe dëshirën për lënien e tyre për shfrytëzim nënës dhe vëllait të tyre, subjektit të rivlerësimit.

22.6 Komisioni e ngarkoi subjektin e rivlerësimit me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar të ardhurat nga bletaria dhe pemëtaria, të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj depozite dyemërore, ngaqë këto të ardhura sipas faturave tatimore janë përfutur vetëm nga nëna e subjektit të rivlerësimit, duke arsyetuar se ky i fundit nuk provoi me dokumente ligjore se investimet për bujqësinë e bletarinë ishin kryer prej tij. Si rrjedhojë e sa më sipër, lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerësoi se të ardhurat e vitit 2016 i përkasin familjes së subjektit të rivlerësimit, pasi rezultoi e provuar se faturat tatimore ishin në emër të nënës së subjektit, që është pjesë e certifikatës familjare të subjektit të rivlerësimit, e cila ka të drejtë t’i disponojë këto shuma sipas vullnetit të saj dhe familjarëve të saj. Në këtë kontekst, konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e kësaj depozite, nuk gjendet i bazuar.

- 23. Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 86,89 m², ndodhur në blv. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit se subjekti ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 3.754.249 lekë për krijimin dhe mobilimin e kësaj pasurie**

është i gabuar dhe jo logjik. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo balancë negative është shumatore e balancave negative të përlllogaritura nga Komisioni në vitet 2011-2014. Sipas subjektit të rivlerësimit në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat nga pemëtaria dhe bletaria, si dhe shuma prej 1.600.000 lekësh, e cila iu dhurua nuses së djalit nga prindërit e saj me rastin e martesës. Në analizën financiare, sipas subjektit të rivlerësimit, ka edhe gabime të tjera për sa u përket shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve jetike. Subjekti i rivlerësimit argumenton në ankim se edhe nëse nuk do të ishin përfshirë të ardhurat e dhuruara nga prindërit e nuses së djalit, përsëri analiza financiare do të rezultonte pozitive.

23.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *“Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion ligjor për vitin 2014, kohë kur është blerë dhe mobiluar apartamenti, me një balancë negative në shumën (-) 3.754.249 lekë, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016”.*

23.2 Në deklaratën vetting, djali i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *“Apartament banimi, me sipërfaqe 86,89 m², i cili ndodhet në katin e gjashtë të godinës 9-katëshe, në rrugën e Kavajës, në emër të I. S., blerë me kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.02.2014 dhe regjistruar me nr. {***} hipotekor, datë 04.03.2014. Blerë me të ardhurat dhe kursimet e mia dhe të prindërve (familjes) gjatë viteve 2010-2014 në shumën 30.000 euro dhe 23.000 euro, sipas kontratës së huas së lidhur me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.10.2014 dhe diferenca prej 1.220.000 lekësh (8.715 euro) nga kursimet e familjes sime dhe prindërve gjatë vitit 2014 (sqaroj se në deklarimin e vitit 2014 kjo shumë është pasqyruar gabim në shumën 1.340.000 lekë) [...]. Vlera e apartamentit është në shumën 53.000 euro”.*

Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit deklaron: *“Blerë banesë në emër të djalit I. S., me sipërfaqe 86,89 m², me kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.02.2014. Shlyer në rrugë bankare me të ardhurat nga kursimet, ndër vite, 30.000 euro dhe 23.000 euro, paguar në rrugë bankare prej huadhënësit Xh. Xh., sipas kontratës së huas së lidhur midis I. S. dhe z. Xh. Xh., me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.10.2014 [...] vlera 53.000 euro. Shitur magazina e ndodhur në fshatin {***}, Kolonjë, me kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.10.2014, të zyrës së noterisë Kolonjë. Të ardhurat i kanë kaluar huadhënësit Xh. Xh. në rrugë bankare. Pjesa tjetër e huas ndaj tij prej 1.340.000 lekësh shlyer nga kursimet e vitit 2014”.*

Në rubrikën “të ardhurat” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Të ardhurat të sjella nga nusja e djalit mbas martesë, dhurata që i kanë bërë prindërit me rastin e martesës dhe dhurata nga dasma e saj, në vlerën 1.600.000 lekë”.*

23.3 Kolegji vëren se nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit, rezulton se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer kursimet familjare të periudhës 2010 – 2014 dhe huaja e marrë te z. Xh. Xh.. Në aktet e administruara në dosjen e Komisionit rezulton kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.02.2014, me palë shitëse shtetasit L. dhe O. L. dhe palë blerëse I. S., për blerjen e apartamentit me sip. 86,89 m², ku si çmim i blerjes është përcaktuar 53.000 euro, likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale, në rrugë bankare, pa asnjë pretendim nga palët kontraktuese. Subjekti i ka bashkëlidhur kontratës: (i) mandatpagesën e “Credins Bank”, të datës 21.02.2014, me të cilin shtetasi I. S. kalon shumën

prej 30.000 eurosh në favor të z. L. L.; dhe (ii) mandatpagesën e “Intesa Sanpaolo Bank”, të datës 21.02.2014, sipas të cilit z. Xh. Xh. ka bërë depozitim *cash* shumë prej 23.000 eurosh, me përshkrim pagesë për llogari të I. S., sipas kontratës së huas me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.10.2014. Sipas kësaj kontrate mes huadhënësit Xh. Xh. dhe huamarrësit I. S., parashikohet se huadhënësi i jep huamarrësit pa interes shumë prej 23.000 eurosh për një periudhë prej 18 muajsh. Në dokumentacionin e administruar në dosje rezulton edhe një deklaratë jo noteriale e datës 28.12.2014, me nënshkrimin e z. Xh. Xh., i cili deklaroi se është likuiduar me huamarrësit me anë të një kalimi në bankë në datën 03.11.2014 nga subjekti i rivlerësimit në shumë 2.000.000 lekë, ndërsa diferencën prej 8.715 eurosh e ka marrë në datën 28.12.2014, *cash* nga I. S. dhe në këtë mënyrë nuk kanë më asnjë detyrim ndaj njëri-tjetrit. Në lidhje me këtë huadhënie, nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti dhe nga analizimi i të dhënave nga institucionet publike, Komisioni konkludoi se huadhënësi ka pasur burime të ligjshme për t’i dhënë huan djalit të subjektit të rivlerësimit.

23.4 Referuar analizës financiare të kryer për periudhën 2011–2014, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultuan me mungesë burimesh financiare të ligjshme, në shumë 3.754.249 lekë. Gjithashtu, shpenzimet e mobilimit të apartamentit të djalit të subjektit, janë deklaruar në shumë totale 1.300.000 lekë, ku si burim ka shërbyer dhurata që prindërit e bashkëshortes kanë bërë për dasmën e vajzës së tyre. Subjektit iu kërkua nga Komisioni dokumentacion mbështetës mbi burimin e ligjshëm të dhuratës martesore të deklaruar nga personi i lidhur në vlerën 1.600.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit paraqiti deklarata noteriale të prindërve të nuses së djalit, si dhe pasqyrat e llogarive të tyre bankare. Komisioni në rezultatet e hetimit i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se: (i) duket se prindërit e bashkëshortes së djalit të subjektit të rivlerësimit kanë mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për vlerat monetare të dhuruara vajzës së tyre, si burim për mobilimin e shtëpisë në shumë 1.600.000 lekë; (ii) referuar analizës financiare të kryer për periudhën 2011–2014, subjekti rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në shumë 3.754.249 lekë, duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

23.5 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit për gjetjet e Komisionit për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se: *“Prindërit e nuses së djalit, me rastin e martesës së vajzës së tyre i kanë dhënë si pajë shumë prej 1.600.000 lekësh (shpenzime për mobilimin). Nga kjo shumë, sikundër është deklaruar edhe në deklaratën periodike dhe në deklaratën vetting nga djali, shuma prej 1.300.000 lekësh është përdorur për mobilimin e shtëpisë. Në këtë shumë përfshihet edhe blerja e dhomës së gjumit të porositur prej dhuruesve dhe në këtë rast nuk do të kishte kuptim zbatimi i nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. [...] Përveç dokumentacionit që ju kam vënë në dispozicion, se sikundër ju kam sqaruar edhe më parë në përgjigjet e dhëna, vlen të përmend faktin që babai i nuses së djalit ka një profesion që siguron të ardhura të konsiderueshme. Ky fakt është konfirmuar edhe në deklaratën e lëshuar prej tij dhe që ju kam vënë në dispozicion. Ai edhe pse në pension pleqërie, ende është aktiv dhe punon si montator i enëve nën preson, pasi për shkak të aftësive të tij, vazhdon të kërkohet nga shumë subjekte që ndërtojnë HEC në vendin tonë dhe që sigurisht është paguar edhe në të zezë. Gjithsesi, dua të sqaroj se në momentin që u martua djali unë, jo vetëm se nuk mund të dija që pas disa vjetësh do të kryhej procedura vetting, por dhe nuk do të ishte as e logjikshme dhe as e moralshme që*

t'i kërkoja nuses së djalit se ku i gjeti babai yt lekët që të ka dhënë si pajë. Sigurisht që edhe po ta dija që do bëhej vetting-u përsëri nuk mund t'i kërkoja llogari nuses së djalit për mënyrën se si i kishte përfituar babai i saj paratë [...]”.

23.6 Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit, trupi gjykues çmoi se nuk mund të kryhet një analizë e thelluar ekonomike për mundësinë e krijimit të shumës prej 1.600.000 lekësh dhuruar vajzës së tyre, për gjendjen financiare të prindërve të nuses së djalit të subjektit të rivlerësimit, duke qenë se mungojnë një sërë dokumentesh si përbërja familjare, dokumentacion i detajuar bankar mbi gjendjen e llogarive, të ardhurat, shpenzimet për blerje pasurish etj. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se të ardhurat e familjes N. kanë qenë shumë të ulëta për të përballuar jetesën. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se mospërfshirja në analizën financiare të kryer në Komision për vitin 2014, të shumës prej 1.600.000 lekësh e dhuruar nga prindërit e bashkëshortes së djalit të subjektit të rivlerësimit, gjendet e bazuar.

23.7 Në Komision, analiza financiare për periudhën 2011-2014 rezultoi me diferencë negative në shumën 3.754.249 lekë, duke mos i konsideruar subjektit të rivlerësimit të ardhurat nga bujqësia dhe bletaria të deklaruara për këto vite në shumën 4.500.000 lekë.

Kolegji ushtroi kontrollin e analizës financiare të kryer në Komision për subjektin e rivlerësimit dhe familjen e tij për periudhën 2011-2014, sipas të cilës rezultoi i drejtë konkluzioni se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të përballojë shpenzimet me të ardhura të ligjshme për diferencën negative në shumën (-) 3.754.249 lekë, për këtë periudhë. Sa më sipër, lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 86,89 m², subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, si dhe të përballojë shpenzimet, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

24. Lidhur me banesën në përdorim në rrugën “{*}”, Vlorë,** subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se: *“Konkluzioni i Komisionit është jo logjik dhe tërësisht i pabazuar në ligjin mbi konfliktin e interesit dhe në kundërshtim me praktikën e Komisionit. Subjekti pretendon se për të arritur në konkluzionin se ankuesi ishte në situatën në dukje ose jo të konfliktit të interesit, Komisioni nuk duhet të citojë dispozitën ligjore përkufizuese, pasi ato shërbejnë vetëm për të kuptuar qartë ligjin dhe nuk mund të bazohet marrja e një mase disiplinore duke cituar vetëm dispozitën”.* Subjekti parashtron në ankim se konfliktin e interesit për shkak të veprimtarisë si gjyqtar, me qëllim sigurimin e paanësisë në gjykim, e parashikon Kodi i Procedurës Civile apo Kodi i Procedurës Penale dhe ashtu siç është analizuar në vendim nuk ekziston ndonjë situatë, nga e cila do të rezultonte se subjekti e ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në kushtet e konfliktit të interesit apo anshmërisë.

24.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë çështje: *“Komisioni arrin në përfundimin se fakti që pronari i apartamentit, që subjekti i rivlerësimit përdorte pa kundërshpërblim, ishte avokat i Dhomës së Avokatisë Vlorë dhe ndiqte çështje në Gjykatën e Apelit Vlorë, ku subjekti ushtronte detyrën, konsiderohet si konflikt në dukje interesi, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 3, pika 4, shkronja “b” e ligjit “Mbi parandalimin e Konfliktit të Interesit”.*

24.2 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka banesë në përdorim me sip. 74,7 m², me adresë: rruga “{***}”, lagjja “{***}”, Vlorë, në pronësi të shtetasit D. H., e

përdorur pa kundërshpërblim. Bashkë me deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar edhe një deklaratë noteriale, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2017, lëshuar nga shtetasi D. H., pronari i apartamentit me sip. 74,7 m². Deklaruesi ka parashtruar në këtë deklaratë se është pronar i këtij apartamenti të ndodhur në Vlorë, të cilin ia ka dhënë në përdorim shtetasit Hysen Saliko, për periudhën 08.11.2016 deri në fund të korrikut 2017. Ky apartament është privatizuar në vitin 1993, sipas ligjit për privatizimin e banesave dhe nuk përdoret nga pronari për shkak se jeton në Tiranë. Shtetasi Hysen Saliko kishte detyrimin për të paguar vetëm shpenzimet e konsumit të energjisë elektrike dhe të ujit. Bashkëngjitur kësaj deklarate gjendet certifikata e pronësisë së këtij apartamenti, në emër të personave D. dhe M. H.

24.3 Sipas deklaratës noteriale të sipërcituar, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur këtë banesë për 9 (nëntë) muaj, ndërsa subjekti i rivlerësimit në pyetësin standard të Komisionit ka sqaruar se e ka përdorur në periudhën janar 2012 deri në nëntor 2016. Nga faktet e rezultuara, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se duket se subjekti ka vepruar në kundërshtim me kodin e etikës së gjyqtarit, duke përdorur shtëpinë e një avokati, pa kundërshpërblim. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit lidhur me barrën e provës, ka sqaruar se: *“Sikundër kam deklaruar edhe në pyetësin standard dhe në përgjigje të e-mail-it të datës 04.03.2019 kam përdorur së bashku me kolegun tim A. C. në periudhën janar 2012 – nëntor 2016, 1 - 2 ditë/javë banesën e shtetasit D. H. (që është vjehri i kolegut A. C.). Nënvizoj faktin se pasuria është lënë në përdorim prej pronarit pa kundërshpërblim për shkak se në të flinte edhe dhëndri i tij, dhe se unë kam fjetur aty me ftesë të kolegut, me të cilin udhëtonim së bashku nga Tirana për në Vlorë. Ka qenë dhëndri i tij që më ka ftuar, pasi edhe rrugën Tiranë – Vlorë e bënim së bashku. Po kështu, këtë banesë kam vazhduar ta përdor i vetëm 1 - 2 ditë/javë edhe për periudhën nëntor 2016 - qershor 2017. Për këtë kam pranuar ta përdor pa kundërshpërblim. Sqaroj se për periudhën 15 korrik - 31 gusht të çdo viti nuk e kemi përdorur për asnjë ditë këtë banesë. Me avokatin jam njohur vetëm pas datës 10 janar të vitit 2012, kur kemi shkuar për të banuar në banesën e tij dhe që nga ajo datë deri më sot nuk kam zhvilluar asnjë proces gjyqësor, ku shtetasi D. H (i njohur si av. D. A.) të jetë palë ose avokat”*.

24.4 Komisioni hetoi për konfliktin e interesit në lidhje me personin D. H. duke i kërkuar informacion Gjykatës së Apelit Vlorë, nëse ky shtetas ka pasur procese gjyqësore, ku në përbërje të trupës gjykuese ka qenë subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko. Gjykata e Apelit Vlorë, me shkresën nr. {***} prot., datë 28.02.2020, ka informuar se ky person ka pasur çështje gjyqësore civile, që i përket vendimit nr. {***}, datë 24.05.2012, por subjekti Hysen Saliko nuk ka qenë në trup gjykues. Gjykata e Apelit Vlorë, me shkresën nr. {***} prot., datë 08.05.2020, ka informuar se nga verifikimi në arkiv, deri më 25.05.2010 (kohë në të cilën është emëruar gjyqtari Hysen Saliko), rezultoi vetëm vendimi nr. {***}, datë 02.08.2010 (kryesues Hysen Saliko), ku përfaqësuesi i të pandehurit S. N., ka qenë avokati D. A.. Vendimi i sipërcituar i është bashkëngjitur shkresës së dërguar në Komision nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe në përmbajtje të tij vërehet se ankimin e ka ushtruar i pandehuri S. N. kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka vendosur ndaj të pandehurit masën e sigurimit “arrest me burg”. Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Vlorë, me kryesues subjektin e rivlerësimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi

nuk përmban shkaqe ligjore që sjellin cenimin e tij. Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, i përfshirë në këtë çështje, në cilësinë e kryesuesit nuk krijon dyshimin se është ndikuar nga avokati D. H., si mbrojtës i të pandehurit, vendimmarrja e të cilit nuk ishte në favorin e klientit të avokatit dhe para periudhës së përdorimit të apartamentit prej subjektit të rivlerësimit.

24.5 Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në “konflikt interesi në dukje” për faktin se z. D. H. ishte avokat i Dhomës së Avokatisë Vlorë dhe ndiqte çështje në Gjykatën e Apelit Vlorë, ku subjekti ushtronte detyrën, bazuar në nenin 3, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për konfliktin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9367/2005). Kjo dispozitë parashikon: *“Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë: [...] b) “konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë”*.

24.6 Trupi gjykues për vlerësimin e kësaj situatë mban në konsideratë se në “Manualin shpjegues mbi parandalimin e konfliktit të interesave”²¹, të ILDKPKI-së shpjegohet se: “Në lidhje me konceptin e konfliktit rast për rast të interesit duhet të përqendrohemi në dy çështje kryesore: *Së pari*, duhet të kemi shfaqjen e një konflikti interesi në formën e konfliktit faktik, në dukje apo të mundshëm. Për këtë qëllim, është e nevojshme t’i referohemi konceptit të konfliktit të interesit dhe këtyre tre llojeve të veçanta të tij. *Së dyti*, konflikti rast për rast është i lidhur me një apo disa vendimmarrje të veçanta, pra, me fjalë të tjera, rënia në konflikt interesi, mundësia e rënies në të ardhmen apo edhe dukja e rënies në konflikt interesi do të gjykohet në bazë të një vendimmarrjeje konkrete dhe rolit të zyrtarit në këtë vendimmarrje. Konflikti rast për rast i interesit është dhe duhet kuptuar si një papajtueshmëri momentale (pra, lidhur me “atë” vendimmarrje) ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit”.

24.7 Sipas trajtimit të konfliktit të interesit nga ILDKPKI-ja në manualin e cituar më sipër, konflikti i interesit lidhet domosdoshmërisht me një situatë të caktuar, çështje konkrete apo vendimmarrje, e cila ka ndodhur ose pritet të ndodhë. Në këtë kontekst duhet të ketë një perceptim objektiv konkret, një shkak potencial që mund të ndikojë në paanshmërinë e gjyqtarit në rastin në fjalë. Në kuptim të sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar që subjekti ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në dukje për situata hipotetike, duke mos iu referuar një rasti konkret ku subjekti i rivlerësimit të ketë shfaqur anshmëri si rrjedhojë e një konflikti interesi, pasi nuk kemi një shkak situatë apo vendimmarrje konkrete favorizuese ndaj avokatit, mbi të cilën të analizohet dhe konkludohet nëse ekziston konflikt interesi. Në përfundim të analizimit të këtij shkak ankimi, Kolegji vlerësoi se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesit në dukje nuk është i bazuar.

- 25. Lidhur me punësimin e subjektit të rivlerësimit pranë Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë** (në vijim “UISH”), subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit me pretendimin se pasqyrimi në kontratë ka qenë jo i saktë, pasi pranë UISH-së ka kryer vetëm aktivitetet mësimdhënës dhe jo konsulencë. Kontrata e lidhur me këtë institucion është një

²¹ <https://ildkpkj.al/wp-content/uploads/2018/12/manual-shpjeg-nr-3.pdf>

kontratë tip dhe vetëm shënimi në këtë kontratë i fjalës “konsulencë” nuk provon faktin që nga ankuesi është dhënë konsulencë për UISH-në. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk mund të shtojë shkaqe për shkarkimin e subjektit pa ia njoftuar më parë me qëllim që të japë argumente dhe të sjellë prova në mënyrë që të mbrohet. Subjekti i rivlerësimit pretendon se shkak i shkarkimit “cenim i besimit të publikut” nuk mund të jetë i aplikueshëm vetëm me verifikimin e një kriteri, por në vlerësimin tërësor të tria kriterëve të procesit të rivlerësimit.

25.1 Komisioni lidhur me këtë çështje ka arritur në konkluzionin: *“Subjekti i rivlerësimit gjatë angazhimit për dhënien e konsulencës juridike për urdhrin e infermierit, përkundrejt pagesës, ndërkohë që ishte gjyqtar, nuk është në përputhje me nenin 143 të Kushtetutës, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016”.*

25.2 Komisionit i ka rezultuar nga llogaria bankare në “Credins Bank” se subjekti i rivlerësimit ka marrë pagesë nga UISH-ja, të ardhura të cilat ai nuk i ka deklaruar. Për këtë arsye, Komisioni ka kërkuar informacion, në përgjigje të të cilit UISH-ja²² ka sqaruar se subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko ka qenë i punësuar me kohë të pjesshme në këtë subjekt, me kontratë që nga data 25.10.2009 deri më 22.07.2011. Në të njëjtën kohë, subjekti ka qenë i punësuar si inspektor i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe më pas që nga data 25.10.2010, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë. Akti me të cilin subjekti i rivlerësimit ka dakordësuar kushtet e punës është i titulluar “aktmarrëveshje punësimi të jashtëm” e datës 25.10.2009 dhe referuar kësaj aktmarrëveshjeje subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko, në cilësinë e konsulentit juridik do të kryente detyra si dhënie konsulence, trajnime dhe seminare të stafit të UISH-së, në bazë qarqe dhe rrethe. Kontrata nënshkruhej për një afat maksimal 2-vjeçar dhe sipas saj është parashikuar se trajnimi do të konsistojë në dhënien e njohurive juridike stafit, legjislacionin penal në fushën mjekësore që kanë të bëjnë me mjekimin e pakujdesshëm, pasojat juridike të infermierëve në Republikën e Shqipërisë, etj.

25.3 Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se subjekti ka ofruar konsulencë juridike pranë Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, që bie ndesh me detyrën e gjyqtarit. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Mësimdhënia dhe trajnimi në kohën që e kam kryer nuk ka qenë e ndaluar për pozicionin e punës që unë kam pasur. Kështu nga nëntori i vitit 2009 deri më 25.05.2010 kam qenë Inspektor i KLD-së dhe pas kësaj date kam qenë gjyqtar Apeli. Unë kam dhënë mësim dhe mësimdhënia nuk ishte një funksion i ndaluar nga ligji dhe njëherazi gjatë kësaj periudhe nuk kërkohej që të merrej leje nga KLD-ja, por pavarësisht kësaj kam vënë në dijeni zëvendëskryetarin. Rregullat për lejimin e mësimdhënies u parashikuan me vendimin e KLD-së nr. {***}, datë 19.07.2011. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, unë kam ndërprerë menjëherë mësimdhënien duke paraqitur kërkesë në UISH, në datën 22.07.2011, për të zgjidhur marrëveshjen e lidhur pa kërkuar që të pajisem me leje nga KLD-ja. Ndërprerjen e kam bërë edhe për shkak të ngarkesës në punë. [...] Ndërkohë që në lidhje me mospasqyrimin e këtyre pagesave, ju deklaroj me përgjegjësi që ka qenë veçse harresë nga ana ime, pasi këto të ardhura janë marrë me bankë dhe janë paguar rregullisht për trajnimet e kryera në fundjavë stafit infermier dhe jo për dhënie konsulence juridike, veprimtari kjo e papajtueshme me statusin e gjyqtarit apo inspektorit të KLD-së”.*

²² Shkresë nr. {***} prot., datë 28.01.2020.

25.4 Kolegji vlerësoi nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur ndalim për të lidhur kontratë pune me këtë subjekt dhe veprimtarinë që ka kryer në kuadër të saj, e cila e kualifikon punën që do kryente subjekti i rivlerësimit si konsulencë juridike, trajnime dhe seminare për stafin e UISH-së.

25.5 Kolegji vëren se nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank” rezulton se ai është paguar sipas kontratës së lidhur me UISH-në, ku rezulton se ka përfituar për vitin 2009 pagesën prej 45.000 lekësh, për vitin 2010 pagesën prej 292.000 lekësh dhe për vitin 2011 pagesën prej 180.000 lekësh. Këto të ardhura subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar në deklaratat periodike të viteve përkatëse (2009, 2010 dhe 2011). Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën “të ardhura [...]”, ka deklaruar: “*Të ardhura nga paga e djalit*²³ I. S. si jurist i jashtëm, punësuar si i tillë tek UISH, për vitin 2011. Shuma e përfituar 270.000 lekë”. Siç rezulton nga kjo deklaratë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shumën prej 180.000 lekësh që ai ka përfituar nga UISH-ja në llogarinë e tij personale në “Credins Bank”, por i ka paraqitur të ardhurat e tij personale si të ardhura të djalit I. S. nga punësimi pranë UISH-së, ndërkohë që djali i subjektit ka përfituar vetëm shumën 90.000 lekë në llogarinë e tij personale bankare. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, jo vetëm që ka fshehur të ardhurën e tij nga punësimi, por në të njëjtën kohë është përpjekur të shtrembërojë situatën e vërtetë faktike lidhur me të ardhurat e realizuara prej tij nga punësimi në vitin 2011. Në këto kushte, është i pabesueshëm pretendimi i subjektit se mosdeklarimi i këtyre të ardhurave në deklaratën periodike ka qenë një harresë nga ana e tij.

25.6 Në nenin 143 të Kushtetutës (varianti fillestar i viti 1998)²⁴ parashikohet: “*Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private*”. Në aktmarrëveshjen e lidhur nga subjekti i rivlerësimit me UISH-në, lloji i punës i parashikuar në të është konsulencë dhe trajnime. Konsulenca juridike nënkupton dhënien e këshillave dhe ndihmës juridike për fusha të ndryshme të së drejtës. Në ligjin nr. 9718, datë 19.04.2007, “Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3 të tij me titull “statusi” parashikohet: “*Urdhri i Infermierit është ent publik jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të profesioneve të infermierit/es, mamisë, fizioterapeutit/es, teknikut/es të/së laboratorit, teknikut/es të/së imazherisë dhe logopedistit/es, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut*”. Sipas këtij parashikimi, Kolegji vëren se UISH-ja është ent publik, i cili nuk financohet nga buxheti i shtetit dhe nuk është institucion arsimor, ku mund të ushtrohet mësimdhënia siç ka pretenduar subjekti i rivlerësimit.

25.7 Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kontratës së punës, kundrejt pagesës ka dhënë konsulencë juridike, veprimtari kjo e ndaluar nga parashikimet kushtetuese dhe ligjore, si dhe ka fshehur këtë punësim dhe të ardhurat e përfituara prej tij gjatë viteve 2009-2011. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se kjo sjellje e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

26. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Hysen Saliko gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 3 dhe

²³ Më datë 05.07.2011, djali i subjektit të rivlerësimit ka lidhur me UISH-në kontratë me kohë të pjesshme pa afat.

²⁴ Neni 143 i Kushtetutës ka ndryshuar me ligjin nr. 76/2016.

5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 284, datë 03.08.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 284, datë 03.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Hysen Saliko.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 30.03.2023.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

Unë, gjyqtari Sokol Çomo, jam dakord me zgjidhjen e çështjes, me vendimin nr. 12, datë 30.03.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 284, datë 03.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Hysen Saliko, por kam mendim paralel me shumicën e trupit gjykues, lidhur me mënyrën e arsytimit të lënies në fuqi të vendimit objekt kontrolli nga Kolegji.

Në përfundim të shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit nr. 284, datë 03.08.2020, arrita në konkluzionin se ky vendim duhej lënë në fuqi, për sa kohë edhe nëse do të konsideroheshin të provuara faktet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e deklaruara prej tij si të realizuara nga bujqësia dhe bletaria, ato nuk do të ndikonin në ndryshimin e vendimit të marrë nga Komisioni, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.

Në arritjen e këtij konkluzioni, jam bazuar në parashikimin e nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit edhe nëse subjekti i rivlerësimit do të kishte arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kontrollin e figurës dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, ai përsëri nuk do mund të konfirmohej në detyrë, për sa kohë Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ndodhej në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se kishte cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, konkluzion ky i cili u gjet i drejtë dhe i bazuar edhe nga Kolegji. Ky qëndrim i Kolegjit erdhi si pasojë e ekzistencës së marrëdhënies së punësimit të subjektit të rivlerësimit me Urdhrin e Infermierit të Shqipërisë, në kundërshtim flagrant me urdhërimet kushtetuese dhe ligjore të kohës²⁵, marrëdhënie kjo e cila në vlerësimin tim ishte fshehur qëllimisht nga subjekti i rivlerësimit, jo vetëm në deklaratimet periodike vjetore pranë ILDKPKI-së, por dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, në plotësimin e së cilës ai mbartte detyrimin kushtetues dhe ligjor për të deklaruar me saktësi, plotësi dhe vërtetësi, çdo angazhim dhe veprimtari private/publike që kishte sjellë të ardhura për subjektin e rivlerësimit.

Në këto kushte, bazuar edhe në parimin e ekonomisë gjyqësore, e kam vlerësuar të panevojshme t'i bashkohem arsytimit të shumicës së trupit gjykues për trajtimin e shkaqeve të ankimit që lidheshin me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për të ardhurat e krijuara nga bujqësia dhe bletaria, në kuadër të vlerësimit të pasurisë së tij dhe personave të lidhur me të.

Për rrjedhojë të sa më sipër, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit nr. 284, datë 03.08.2020 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Hysen Saliko, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, bazuar në parashikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

²⁵ Shih arsytimin e vendimit në paragrafët 25 e vijues.

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes për vendimin nr. 12 (JR), datë 30.03.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 284, datë 03.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Hysen Saliko, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa parashtruar në vijim.
2. Në paragrafin 18.11 të vendimit të Kolegjit është arsyetuar se mandatarëkëtimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk janë një dokumentacion zyrtar i hartuar, lëshuar, administruar, regjistruar dhe kontrolluar nga organet tatimore, por rezulton se janë hartuar nga familjarët e subjektit të rivlerësimit, pa pasur përgjegjësi ligjore, në raport me administratën tatimore ose ndonjë institucion tjetër shtetëror, duke ngelur në nivelin e një shkrese të thjeshtë private dhe pa vlerë provuese përcaktuese. Për këtë arsye, trupi gjykues ka konkluduar se nuk krijonin bindjen që mandatarëkëtimet janë reale, duke i çmuar ato pa vlerë provuese, lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga subjekti i rivlerësimit prej bujqësisë dhe bletarisë.
3. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar të ardhurat e përfituara nga shitja e produkteve bujqësore dhe bletaria, ka paraqitur në Komision, së bashku me përgjigjet e pyetësorit të Komisionit datë 19.11.2019, edhe 226 mandatarëkëtime në lidhje me shitjet që ka kryer e ëma e tij për periudhën 2010-2016. Sa i përket krijimit të bindjes, lidhur me vërtetësinë e këtyre mandateve, vlerësoj se në një vështrim *prima facie* ato janë plotësuar në mënyrë të rregullt dhe të plotë në të gjitha rubrikat e tyre dhe, konkretisht kanë një numër dhe datën në të cilën është kryer veprimi i shitjes, numër llogarie, emrin e personit nga i cili janë arkëtuar të ardhurat, përshkrimin e produktit dhe sasinë e blerë, emrin dhe firmën e arkëtarit dhe personit i cili ka arkëtuar paratë.
4. Duke qenë se e ëma e subjektit të rivlerësimit rezulton të ketë qenë me statusin e të vetëpunësuarit në bujqësi/fermerit, në vlerësimin tim çështjet të cilat do të duhet të trajtohen për të konsideruar me vlerë provuese mandatarëkëtimet e depozituara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe të ligjshme të ardhurat e përfituara nga kjo veprimtari janë:
 - a) a përcaktonte legjislacioni në fuqi rregulla të detyrueshme për t'u zbatuar lidhur me dokumentimin e të ardhurave të përfituara nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtoria²⁶, si dhe
 - b) a përcaktonte legjislacioni në fuqi pagim detyrimesh tatimore për produktet bujqësore dhe blegtoria?
5. Sa i përket çështjes së parë, ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"²⁷, i ndryshuar [në vijim ligji nr. 9928/2004], zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike të vendosura në Republikën e Shqipërisë, që kanë qëllime fitimprurëse, përfshirë institucionet financiare dhe shoqëritë kontrolluese, pavarësisht nga forma e tyre juridike ose nga kërkesat e veçanta ligjore, që mund të zbatohen ndaj tyre. Referuar përkufizimit në paragrafin 5, të nenit 3 të këtij ligji, "njësi ekonomike" janë personat juridikë dhe fizikë, publikë dhe privatë, me dhe pa qëllim fitimprurës, që kryejnë veprimtari dhe kanë seli të përhershme

²⁶ Në veprimtarinë e blegtorisë përfshihet dhe bletaria.

²⁷ Ligji në fuqi, i kohës, për periudhën në të cilën janë realizuar të ardhurat nga bujqësia dhe bletaria.

në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, sipas përkufizimit, në paragrafin 6 të po këtij ligji, “njësi ekonomike që ndjekin qëllime fitimprurëse” janë njësitë ekonomike, të cilat prodhojnë e realizojnë produkte, mallra e shërbime për shitje, me qëllim realizimin e fitimeve, të cilat parashikohen t’u shpërndahen personave investues në kapitalin themeltar të saj.

6. Veprimtaria bujqësore dhe blegtorale e të vetëpunësuarve në bujqësi nuk është një veprimtari, e cila realizohet në kuadër të një njësie ekonomike të organizuar/formalizuar me një personalitet juridik sipas legjislacionit në fuqi, e cila ka për qëllim shpërndarjen e fitimeve te personat investues në kapitalin themeltar. Për rrjedhojë, në interpretim të dispozitave ligjore të sipërcituara, për veprimtarinë bujqësore dhe blegtorale të ushtruar nga fermerët, nuk gjejnë zbatim përcaktimet e ligjit nr. 9228/2004 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
7. Bazuar në sa më sipër, duke qenë se i vetëpunësuarin në bujqësi/fermeri nuk është subjekt, sipas legjislacionit të mësipërm, si dhe duke qenë se nuk është subjekt raportues në organet tatimore²⁸, ai nuk mund të ketë në administrim dokumentacion financiar zyrtar [mandate dhe fatura me numër serie] apo pasqyra financiare të cilat të dokumentojnë veprimtarinë e shitjes së produkteve bujqësore dhe blegtorale. Për rrjedhojë, është e pamundur që të identifikohet se cili duhet të ishte dokumentacioni kontabël ku duhet të ishin të regjistruara mandatarkëtimet e sjella në kuadër të këtij procesi nga subjekti i rivlerësimit, për t’i bërë ato bindëse në drejtim të provueshmërisë së të ardhurave të fituara. Për më tepër, çmoj të theksoj që, për vetë natyrën e veprimtarisë bujqësore dhe blegtorale, shitja në sasi të vogla, të përditshme apo në periudha të shkurtra kohore/sezonale, por dhe mospërdorimi nga fermerët për transaksionet e shitjes i institucioneve financiare/bankare, si dhe mungesa e një detyrimi ligjor për raportimin e tyre në organet tatimore, duket se bëjnë të pamundur të identifikosh një dokumentacion financiar zyrtar që duhet të paraqitet në kuadër të këtij procesi me qëllim krijimin e bindjes për përfitimin real të këtyre të ardhurave. Në përfundim, lidhur me këtë çështje, vlerësoj se vendosja e një barre të tillë, përveç se nuk gjen mbështetje në legjislacionin në fuqi, është një barrë jo proporcionale provueshmërie për subjektin e rivlerësimit që ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore të pasurisë dhe në deklaratën *vetting*²⁹ se ka realizuar/përfituar të ardhura nga veprimtaria bujqësore dhe blegtorale.
8. Lidhur me çështjen e dytë, në verifikim të legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht të ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar [në vijim ligji nr. 8438/1998], konstatohet se në nenin 8, pika 1 nuk ka përfshirë brenda përcaktimeve të tij pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga veprimtaria bujqësore dhe blegtorale. Gjithashtu, edhe udhëzimi nr. 5, datë 30.01.2006, i Ministrisë së Financave, në pikën 2.3.9, ku parashikohen rastet e tjera të deleguara për t’u përcaktuar me akte nënligjore nga germa “g”, e pikës 1, të nenit 8 të ligjit nr. 8438/1998, nuk përfshin si të ardhura të tatueshme të ardhurat e përfituara nga veprimtaria bujqësore dhe blegtorale. Prej vitit 2012, në legjislacion u përfshi skema e rimbursimit e TVSh-së për të vetëpunësuarin në bujqësi/fermerin, nëpërmjet së cilës fermerët që kërkonin rimbursim të TVSh-së duhet të deklaronin shitjet e tyre. Nga analizimi i legjislacionit të zbatueshëm nuk evidentohen dispozita ligjore që të kategorizojnë të ardhurat nga shfrytëzimi i pemëve frutore, arrorëve dhe bletëve si të ardhura të tatueshme³⁰. Detyrimi që prodhuesit e produkteve bujqësore dhe blegtorale kanë kundrejt organeve shtetërore janë taksat vendore për

²⁸ Sipas interpretimit dhe vlerësimit të bërë në paragrafin 8 në vijim.

²⁹ Sipas shtojcës 1 të ligjit nr. 84/2016.

³⁰ Qëndrim ky i mbajtur nga Kolegji në paragrafin 13.19 të vendimit (JR) nr. 20, datë 14.06.2022 dhe në paragrafin 21.7 të vendimit (JR) nr. 3, datë 06.02.2023.

tokën bujqësore, të parashikuara nga neni 9, pika 2 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për të provuar shlyerjen e taksave vendore për tokën bujqësore, me parashtrimet në Kolegj, subjekti depozitoi vërtetime të lëshuara nga Bashkia Kolonjë, në të cilat provohet se e ëma ka paguar taksën e tokës bujqësore.

9. Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se të ardhurat e përfituara dhe të provuara me mandatarkëtimet e depozituara në kuadër të këtij procesi nga subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2010-2016, si dhe të deklaruara në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme.
10. Bazuar në përfundimet e mësipërme, nga analiza financiare e kryer në Kolegj nga Njësia e Shërbimit Ligjor [në vijim NjShL] për vitin 2010, duke përfshirë në analizën financiare të ardhurat e gjeneruara nga subjekti i rivlerësimit nga bujqësia dhe bletaria, të deklaruara në deklaratën periodike të këtij viti, për të cilat është paraqitur edhe dokumentacioni mandatarkëtimet, rezulton se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të mjaftueshme financiare për krijimin e pasurisë *apartment banimi me sip. 106,44 m²*, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.
11. Sipas analizës financiare të kryer në Kolegj nga NjShL për periudhën 2011-2014, duke përfshirë në analizën financiare përsëri të ardhurat e gjeneruara nga subjekti i rivlerësimit nga bujqësia dhe bletaria, të deklaruara në deklaratat periodike, për të cilat është paraqitur edhe dokumentacioni mandatarkëtimet, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të përballojë shpenzimet me të ardhura të ligjshme për vitin 2011 në vlerën 187.677 lekë, ndërsa rezulton me diferencë pozitive për vitet 2012, 2013 dhe 2014. Bazuar në këto rezultate financiare të verifikuara në Kolegj, lidhur me pasurinë *apartment banimi me sip. 86,89 m²*, subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura, për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, si dhe të përballojë shpenzimet në vitin përkatës.
12. Në lidhje me analizën financiare të blerjes së pasurive dy garazhe me sipërfaqe 15,8 m² secili, të blera në vitin 2015, nga analiza financiare e kryer në Kolegj nga NjShL, pas përfshirjes përsëri në këtë analizë të të ardhurave nga bujqësia dhe bletaria, do të rezultonte se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë pasuritë garazhe dhe të përballojë shpenzimet e jetesës për vitin 2015.
13. Në përfundim, bazuar në sa vlerësuar dhe konkluduar më sipër, në ndryshim nga shumica, mendoj se për pasuritë e analizuara në paragrafët 10, 11 dhe 12 më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që konfirmoj të njëjtin qëndrim me shumicën për konkluzionet e tjera të pasqyruara në vendim për kontrollin e kriterit të pasurisë.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi